



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË
ANALIZA VJETORE E VITIT 2024

(Sipas shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm 101 prot, datë 20.01.2025)



1. HYRJE

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë, Urdhërit nr. 330, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për përmbajtjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë paraqes para Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë Raportin Vjetor të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, mbi treguesit sasiorë dhe cilësorë të punës së kësaj Prokurorie si dhe gjëndjen e kriminalitetit për vitin 2024.

Realizimi i reformës në drejtësi ka sjellë efektet e veta në gjithë sistemin e Drejtësisë, por duhet pranuar fakti që në këtë moment në funksionimit të Prokurorisë, efektet e reformës kanë krijuar jo në pak raste, mbi ngarkesa në hetim të prokurorëve duke shkaktuar edhe cënuar në një farë mase edhe cilësinë e performancës së prokurorit në hetim.

Në një periudhë reformash të thella që i përkasin Sistemit të Drejtësisë, në përgjithësi, por edhe figurës ligjore specifike të Prokurorit, ngelet gjithmonë një sfidë më vete gjetja e ekuilibrit të duhur mes nevojës për t’u përshatatur me një formë të re të ushtrimit të ndjekjes penale, efikasitetit të ushtrimit të kontrollit të gjykatës dhe arritjes së rezultateve sa më të kënaqshme përgjatë gjithë procesit të hetimit dhe ajo që është edhe më e rëndësishmja në finalizimin e suksesshëm të procesit të gjyqimit.

Para figurës së një modeli prokurori të pavarur qëndron një detyrim i shtuar për përgjegjshmëri më të lartë, por edhe për rezultate akoma edhe më efikase në hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale, në kushtet kur Prokuroria Shqiptare ka funksionuar si një trupë e centralizuar.

Përgjatë vitit 2024, trupa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka ushtruar me një shkallë të lartë përgjegjshmërie ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq si dhe realizimin e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj.

Sipas organizimit të brendshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë kanë funksionuar tre Seksione, përkatësisht Seksioni kundër krimit të organizuar, narkotikëve, korrupsionit, krimit në sferën ekonomike, në përbërjen e të cilit ka 3 prokurorë

dhe Seksioni i Përgjithshëm, i cili ka në kompetencën e hetimit të gjithë kategorinë tjetër të veprave penale dhe Seksioni i të Miturve, i cili ka në kompetencën lendore të tij hetimin e veprave penale ku i mituri është i dyshuar apo viktime e veprës penale.

Nëpërmjet këtij materiali do të paraqesim treguesit e punës së veprimtarisë së përgjithshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, realizuar gjatë vitit 2024, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin paraprak dhe në gjykim si dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore nga Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Njëkohësisht do të parashtrojmë në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës, të metat e konstatuara në punën tonë, shkallën e performancës së Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Gjej rastin, në fakt për të falenderuar të gjithë trupën e prokurorëve por edhe oficerëve të policisë gjyqësore për punën e kryer gjatë këtij viti, duke vlerësuar dhe aspiruar për rezultate akoma edhe më të mira në vijim.

2. MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURIALE

Përgjatë vitit 2024, trupa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka ushtruar me një shkallë të lartë përgjegjshmërie ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq si dhe realizimin e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj.

Organika dhe seksionet: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për ushtrimin e veprimtarisë së saj kishte një organikë prej 59 punonjësish definitivë dhe 1 punonjës me kontratë, më kohë të pjesshme. Nga këta, 20 janë prokurorë (duke përfshirë drejtuesin dhe zv/drejtuesin) 15 janë oficerë të policisë gjyqësore dhe të tjerët punonjës në administratë. Në fakt, për shkak të mungesave në organikë, në fillim të vitit 2024 ka pasur 10 prokurorë (duke përfshirë drejtuesit) dhe 11 oficerë të policisë

gjqësore. Gjatë muajve pasardhës organika faktike ka ndryshuar me largime dhe prurje prokurorësh dhe përfundoi në fund të dhjetorit me 15 prokurorë (bashkë me drejtuesit) dhe 10 oficerë të policisë gjyqësore. Kjo gjëndje është pasojë e transferimeve, komandimeve, largimeve ne vendim të KPK dhe emërimeve të reja.

Tabelë organike numerike e prokurorisë në fund të vitit 2024

Funksioni	Organika	Efektivë	Meshkuj	Femra
Drejtues	1	1	0	1
Zv/Drejtues/e	1	1	0	1
Prokurore/ë	18	13	3	10
Gjithsej Prok.	20	15	3	12
OPGj	15	10	7	3

Administrata sipas organikës përbëhet nga 1 kancelar, 1 kryesekretare, 1 përgjegjëse e zyrës së financës, 2 shoferë, 1 ftues, 1 punonjës shërbimi, 1 punonjës mirëmbajtës, 1 specialist I.T, 10 sekretare pranë prokurorëve, 1 koordinatorë, 2 specialiste arkivi, 2 punonjëse pastrimi dhe 1 arkivist me kohë të pjesshme.

Sipas organizimit të brendshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë kanë funksionuar rregullisht tre seksione, Seksioni i Posaçëm “Kundër krimit të organizuar, narkotikëve, korrupsionit, krimit në ekonomi si dhe krimeve të kryera nga subjekte të posaçme”, në përbërjen e të cilit ka 3 prokurorë, Seksioni “Për të mitur, dhe Seksioni i juridiksionit të veprave penale të përgjithshme, i cili mbulon çështjet penale të referuara nga Komisariatet Korçë, Devoll, Kolonjë” në përbërjen e të cilit ka pasur sipas periudhave 6 deri 12 prokurorë.

Pavarësia dhe roli aktiv i prokurorit:

Realizimi i reformës në drejtësi ka sjellë efektet e veta në gjithë sistemin e Drejtësisë, por duhet pranuar fakti që në këtë moment në funksionim të Prokurorisë, efektet e reformës kanë krijuar jo në pak raste, mbi ngarkesa në hetim të prokurorëve duke shkaktuar edhe cënuar në një farë mase edhe cilësinë e performancës së prokurorit në hetim.

Në një periudhë reformash të thella që i përkasin Sistemit të Drejtësisë, në përgjithësi, por edhe figurës ligjore specifike të Prokurorit, ngelet gjithmonë një sfidë me vete gjetja e ekuilibrit të duhur mes nevojës për t'u përshatatur me një formë të re të ushtrimit të ndjekjes penale, efikasitetit të ushtrimit të kontrollit të gjykatës dhe arritjes së rezultateve sa më të kënaqshme përgjatë gjithë procesit të hetimit dhe ajo që është edhe më e rëndësishmja në finalizimin e suksesshëm të procesit të gjykimit.

Përgjatë vitit 2024 janë trajtuar 10 procedime kryesisht nga të cilat 5 janë regjistruar gjatë këtij viti. Në pjesën më të madhe të rasteve prokuroria ka investuar oficerë pranë Drejtorisë së Policisë Korçë, për të kryer veprimet e para hetimore lidhur me rastin e vlerësuar objekt hetimi për ti përcjellë më pas në formën e referimit të veprës penale. Prokuroria vlerëson se është e rëndësishme që të rritet akoma edhe më shumë roli aktiv i prokurorisë në formën e rregjistrimit të çështjeve penale kryesisht, duke qënë kështu në dinamike të plotë me të dhënat dhe indicjet e referuar nga burime të ndryshme informacioni.

Procedime penale me hetime proaktive dhe veprat penale të rënda:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, i ka kushtuar një rëndësi specifike hetimit proaktiv, hetim i cili në pjesën më të madhe të rasteve është shoqëruar edhe me rezultate të sukseshme që lidhen me arrestimin dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve të veprës penale. Gjatë këtij viti, janë inicjuar një numur i konsiderueshëm rastesh që lidhen me hetimet proaktive por edhe hetime të tjera të thelluara, të cilat kanë kërkuar një nivel bashkëpunimi në rang ndërkombëtar. Hetimet proaktive dhe të thelluara gjatë këtij viti kanë qënë të lidhura kryesisht me veprat penale që lidhen me narkotikët, kryesisht në formën e trafikimit të narkotikëve, por edhe në rastet e ndihmës së ofruar për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror, rrethanë e diktuar nga rritja e këtyre veprave penale në qarkun e Korçës. Gjatë vitit 2024 janë paraqitur 54 (pesëdhjetë e katër) kërkesa për lejim

përgjimi apo zgjatje e afatit të përgjimit, të cilat janë pranuar në 100 % të rasteve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kështu, gjatë vitit 2024 kanë qënë objekt i hetimit rreth 208 çështje penale që i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 283 dhe 283/a i Kodit Penal, nga të cilat janë përfunduar 113 çështje, krahasuar me 50 çështje penale të përfunduara në vitin 2023. Janë dërguar për gjykim 124 të pandehur ose më shumë se dyfishi i atyre të dërguar për gjykim në vitin 2023. Ndërkohë numri i procedimeve penale të trajtuara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal është 16 procedime, 4 nga të cilat janë regjistruar gjatë këtij viti. Ka përfunduar hetimi në 10 procedime penale, 3 prej të cilave janë dërguar për gjykim. 24 çështje janë trajtuar për veprën penale të vrasjes (të parashikuara nga neni 76-79 të Kodit Penal), nga të cilat 8 çështje me 11 të pandehur janë përfunduar. Ndërkohë që ka patur 3 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal, nga të cilat është pushuar 1 çështje dhe një tjetër është pezulluar.

2.1 PËRPARËSITË NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE PRIORITARE TË PROKURORISE NW ZBATIM TE KUSHTETUTES DHE LIGJIT, UDHËZIMEVE TË PËRGJITHSHME TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM, REZOLUTËS SË KUVENDIT DHE REKOMANDIMEVE PRIORITARE TE KESHILLIT TË MINISTRAVE

Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor si një organ i pavarur, që garanton mbarëvajtjen dhe kontrollin e veprimeve të saj. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Pikërisht me këtë qasje të re kushtetuese, misioni dhe detyrat e Prokurorisë ngelen një sfidë për vetë institucionin, por edhe në raportet e këtij institucioni me Gjykatën, e cila është kontrollori i veprimeve më të rëndësishme të Prokurorisë gjatë gjithë fazave të ushtrimit të ndjekjes penale.

Udhëzimi nr. 10/2020, I Prokurorit të Përgjithshëm specifikisht neni 4 i tij i ka dhënë një dimension të ri luftës kundër veprave penale kundër pastrimit të

parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, pasi ka përqëndruar në një grup të specializuar prokurorësh dinamikën e hetimit të këtij grupi veprash penale. Në këto kushte pritshmëritë për këtë Seksion janë të mëdha.

Në unison edhe me strategjinë qeveritare kundër krimit dhe korrupsionit, por edhe nën ndikimin e pashmangshëm të perceptimit të nevojës për të ashpërsuar politikën penale ndaj asaj kategorie veprash penale që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit, edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor i ka kushtuar një vëmendje të shtuar veprave penale që lidhen me krimin ekonomik. Ngelet për t'u theksuar fakti që në këtë Prokurori ka funksionuar "Seksioni kundër Krimit të Organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, krimit në ekonomi si dhe krimeve të kryera nga subjektet e posaçme", i krijuar mbi bazën e Udhëzimit nr. 1, datë 20.12.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, por i konfiguruar edhe sipas Udhëzimit nr. 10, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm".

Pastrimi i produkteve të veprës penale:

Gjatë vitit 2024 ka patur 14 (katërmëdhjetë) procedime penale të reja, të rregjistruara për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, që ju janë shtuar procedimeve të mbartura nga viti i kaluar, duke shkuar në 59 procedime në hetim dhe 2 procedime të mbartura në gjykim. Kanë përfunduar 16 procedime penale (14 pushuar, 1 pezulluar dhe 1 transferuar).

Një problematikë që konstatohet në hetimin e çështjeve penale që lidhen me veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal është mungesa e finalizimit me vendimarrje për dërgimin e çështjeve për gjykim, pasi rezulton se numurin më të madh të vendimarrjeve për këto raste e ze vendimi i pushimit. Por ndryshe nga vitet e tjera, gjatë vitit 2024 është konkluduar në ngritjen e akuzës për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e

parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndërkohë që ngritja e akuzës për këto raste është shoqëruar edhe me vendosjen e sekuestros preventive. Tipologjia e hetimit të këtyre veprave penale ka qënë në kushtet e pamundësisë së verifikimit të lidhjes shkakësore mes pasurisë së evidentuar dhe produktit të veprës penale për të cilën është dyshuar apo dënuar personi në hetim. Ne qarkun e Korçës ka qënë një fenomen tipik edhe emigracioni ekonomik, i cili në mjaft raste ka shërbyer edhe si alibi e personave të dyshuar apo nën hetim për të përligjur pasurinë e tyre. Informaliteti i ekonomisë shqiptare është në fenomen i cili referuar tipologjisë së veprave penale të hetuara në Prokurorinë e Korçës, ka vështirësuar procesin e të provuarit të ligjshmërisë së pasurisë së personit nën hetim për veprën penale të pastrimi i produkteve të veprës penale.

Njëkohësisht në disa procedime penale të hetuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë janë sekuestruar në mjaft raste llogari bankare, referuar trasansioneve të dyshimta me origjinë shtetin shqiptar, por me vende destinacioni edhe vende te tilla si shteti Grek, Bejrut, Liban, shteti Francez, etj. Deri në këtë moment procedural rezulton se drejtimi dhe metodologjia kryesore e hetimit të këtyre rasteve ka qënë e orientuar drejt kërkimit të ndihmës juridike drejtuar autoriteteve të huaja, në varësi të llojit të transaksionit të dyshimtë, objekt hetimi. Por në të gjitha rastet, hetimi ka qënë i përqëndruar edhe drejt subjektit dërgues apo pritës të shumave të dyshimta të të ardhurave.

Një tjetër tipologji e veprave penale të hetuara lidhur me veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e parashikuar nga neni 287 I Kodit Penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë kanë qënë edhe rastet e hetimit të fokusuara në ekzistencën e pasurive në disponim të personave për të cilët disponoheshin të dhëna se kishin burime të ligjshme të pasurisë. Në këto raste hetimi është thelluar në identifikimin e pasurive që dispononte personi i dyshuar në territorin e Shqipërisë, por jo vetëm, si dhe në kryerjen e një hetimi të thelluar financiar mbi verifikimin e faktit nëse personi mundej të përligjte pasurinë e tij me të ardhurat e ligjshme apo jo. Në këto raste organi procedurës ka kërkuar ndihmën e ekspertëve kontabël me qëllim përpilimin e akteve të detajuara të ekspertimit për verifikimin e ekzistencës së përputhjes mes të ardhura të ligjshme dhe pasurisë së evidentuar.

Një tjetër burim i referimit dhe marjes së indicjeve lidhur me veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” kanë qënë edhe faktet që kanë rezultuar nga hetimi i çështjeve të tilla si “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “Kultivimi i bimëve narkotike”, e parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, si dhe në rastet e veprave penale të “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Në këto raste, hetimi i veprës penale bazë është shoqëruar edhe me fillimin e kryerjes së hetimit pasuror, që në mjaft raste është shoqëruar me rregjistrimin dhe fillimin e një çështje të mirëfilltë penale për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Problematikat që kanë hasur prokurorët në raport me administrimin e të dhënave prej ASHK-ve vendore, të cilët kanë kërkuar prej Institucionit aplikimin dhe tarifimin ashtu sikurse të gjitha subjektet e tjera procedurale, në një kohë kur fondet për të kryer këto pagesa janë të limituara, kanë cënuar dhe vijnë të cënojnë performancën dhe efikasitetin në drejtim të hetimit të veprave penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” apo dhe për procedimet pasurore.

Nga ana e një prokurori pranë kësaj prokurorie është paraqitur një analizë e detajuar e cila vlerësoj se duhet patur në konsideratë për analizën ligjore lidhur me këtë problematike. Kështu:

Së pari : ASHK i referohet nenit 63 të Ligjit Nr.111/2018 *Për Kadastrën* si dhe posaçërisht pikave 6 e 9 të VKM-së Nr.389, datë 13.05.2022 *Për Miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale* ku është parashikuar se Gjykatat, Prokuroria, etj kur në kuadër të veprimeve kushtetuese dhe ligjote kanë nevojë për marrjen e dokumentave, janë të obliguar të paraqesin kërkesën online dhe jo me shkrim.

Prokuroritë dhe Gjykatat në Republikën e Shqipërisë veprojnë në bazë të dispozitave të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, ligjit nr.8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe dispozitave të ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 *“Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar.

Në analizë të nenit 4 të K.Pr.Administrative evidentojmë dy elementë të këtij parimi, *i pari* evokon në rend kushtetues detyrimin që akti administrativ

duhet të respektojë përputhshmërinë me hierarkinë e normave që janë në fuqi në republikën e Shqipërisë dhe së dyti ligjvënësi e kalon fokusin në detyrimin e organit për të respektuar kufijtë e kompetencave dhe qëllimin për të cilin ja dhënë këto kompetenca, duke synuar në pasojën ligjore që vjen nga akti.

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenin 223 parashikon marrja e provave tek të tretët, ku citohet se: *“Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që*

nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj.

Në këtë rast gjykata jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre...”

Neni 191 i ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, parashikon marrjen e dokumentave:

- 1. Lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër.*
- 2. Kur origjinali i një dokumenti është prishur, ka humbur ose është zhdukur, mund të merret kopja.*
- 3. Dokumentet që përbëjnë provë materiale duhet të merren cilido qoftë personi që i ka krijuar ose që i mban.**

Insitimi i ASHK-së për aksesimin vetëm në mënyrë elektronike vjen në kundërshtim edhe me nenin 10 pika 2 të Ligjit Nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, ku parashikohet se:

Neni 10

Parimi i dhënies së ndihmës aktive

- 2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.**

Gjykata Kushtetuese^[1], në jurisprudencën e saj, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet

^[1] Shih vendimet nr.2, datë 03.02.2010; nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese

juridike më të larta si në kuptimin formal, **ashtu edhe atë material**. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor

Parim i shtetit të së drejtës gjen shprehjen e vet, jo vetëm në nenin 116 dhe 118 të Kushtetutës që parashikojnë aktet me fuqi më të lartë në raport me njëri tjetrin dhe në detyrueshmërinë e nxjerrjes së akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë, por dhe në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 191 të Kodit të Procedurës Penale.

Sikurse vërehet nga relativity i akteve ligjore e nënligjore, nga fusha e veprimit, hierarkia e normave ligjore dhe aplikueshmeria e tyre, prevalojnë dispozitat e ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dispozitat e ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar **në raport me ligjin** nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe VKM nr. 389 datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale” i ndryshuar, në rastin konkret për arsye se:

- **Dispozitat e një Kodi prevalojnë ndaj çdo akti tjetër ligjor e nën ligjor** sepse Kodet miratohen me 2/3 e gjithë deputetëve të parlamentit, ndërsa akti ligjor, pra ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën” miratohet me shumicë të thjeshtë e ndërsa akti nënligjor, konkretisht VKM nr. nr. 389 datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale” i ndryshuar, nuk ndjek një procedurë të tillë miratimi, por mjafton të firmoset nga Ministri Përgjegjës dhe Kryeministri.
- Sa më sipër, **pretendimet e ASHK-së të bazuara në nenin 63 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe pikës 9 të VKM-së nr. 389 datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale” i ndryshuar, nuk janë të aplikueshme ndaj prokurorive dhe gjykatave, pasi këto akte ligjore dhe nënligjore bien në kundërshtime me nenet 4 e 10 të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 191 të Kodit të Procedurës Penale.**

Së dyti : Në lidhje me kërkesës së ASHK-së se pas realizimit të shërbimit të kryhet pagesa ku minimalisht për cdo kopje të njësuar të dokumentave tekniko-ligjore tarifa është 200 Leke / Faqe dhe cdo kopje e HTR-së apo KPP –së tarifohet 1000 Leke, evidentohet se tarifat e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, ku parashikohet se :

Neni 13

Kostoja e shërbimit

1. Shërbimet e administratës publike janë **pa pagesë**. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. **Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij.** Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.

2. Kostoja e **riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni.** Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.

Së treti : Në shkresën e ASHK-së theksohen se “është i pamundur realizimi i veprimeve në mënyrë manuale në rregjistrat kadastral për vendosjen e shënimeve të sekuestros për pasuritë”.

Nëse nga ASHK sekuestro nuk vendoset edhe në rregjistrin manual atëherë nga ASHK **de facto** nuk është ofruar shërbimi për hedhje e të dhënave në Rregjistrin Kadastral.

Në nenin 3 pika 5 të Ligjit Nr.111/2018 Për Kadastrën, përkufizohet:

5. “Kadastër”, “regjistër kadastral” ose “regjistër i pasurive të paluajtshme” **është regjistri publik, manual dhe digjital**, i përbërë nga bashkësia e kartelave dhe hartave kadastrale ...

Sa më sipër rezulton se problemi i pasqyrimit të shënimeve qëndron tek ASHK që në modulën e saj të regjistrimit digjital nuk e përshtatet për realizimin të veprimeve që historikisht janë realizuar manualisht dhe të shoqëruara me dokumentacion në letër por insistohet në aplikimet on-line dhe tarifimin e organeve të pavarura e kushtetuese për fotokopjet e akteve që arkivohen pranë saj.

Prokuroria e Përgjithshme duhet të adresojë kritikën e mësipërme ASHK-së, e cila nuk duhet të behet pengesë në ushtrimin e funksionit kushtetues të

Prokurorisë për hetimin e veprave penale dhe sa herë që i kërkohet të përmbushen detyrimet e përcaktuara nga Prokuroria për paraqitjen e dokumentacionit, i cili duhet të jetë i shoqëruar me vule lidhëse të institucionit dhe pa pagese ose me pagesën e kostos së reale të materiali leter (2 leke / fleta).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas nenit 134 të Kushtetutës duhet të diskutohet mbi mundësinë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për Shfuqizimin e VKM-së Nr.389, datë 13.05.2022 *Për Miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale*, pasi ky akt nën ligjor i pa harmonizuar me ligjet në fuqi, që vjen në kundërshtim me parimin e hiarkisë dhe ligjshmërisë cënon ushtrimin e ndjekjes penale nga Prokuroret e R.Shqipërisë.

Prokuroria vlerëson se në kuadër të rritjes së efikasitetit të hetimit të këtyre veprave penale, po jo vetëm, në zbatim edhe të rezolutës së Kuvendit, datë 06.07.2023, do të jetë një element shumë i rëndësishëm organizimi i takimeve me operatorët telefonike, bazuar në nenin 108/a të ligjit nr. 97/2016 për të siguruar aksesin e drejtpërdrejtë në regjistrat elektronike të abonentëve celularë.

Po aq e rëndësishme është edhe rritja e aksesit të drejtpërdrejtë teknik të përdorimit të të dhënave në databaza shtetërore dhe/ose institucione publike, si dhe për ato kërkesa që janë në proces për të mundësuar të drejtën e aksesit të drejtpërdrejtë sipas ligjit për lehtësimin e hetimeve.

Rekomandimet e FATF, të cilat zbërthehen në Direktivën Evropiane 91/308/KE të Qershorit të vitit 1991, "Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave" duhen vlerësuar me kujdes nga ana e Prokurorisë dhe të jenë pjesë e fokusit në rastin e marrjes së indicjeve fillestare si dhe për hetimin e kësaj tipologjie të veprës penale.

Kjo Direktivë ka meritën për të tërhequr vëmendjen e prokurorëve në drejtim të shtimit të fokusit gjatë hetimit për faktet si më poshtë vijon:

-Zgjeron fushën e zbatimit të saj, duke përfshirë përveç institucioneve të kreditit, (bankave), edhe institucioneve financiare dhe profesione që

mund të përdreshin për pastrim parash, si avokatët, noterët, kazinotë, pasuritë e patundshme etj.;

Ridimensionon konceptim e pastrimit të parave të përdorur në Konventën e Vjenës, duke zgjeruar aktivitetin kriminal përtej prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve. Çdo vend, ka tani të drejtën të zgjerojë aktivitetet kriminale ku mbështetet pastrimi i parave;

-Kërkon shprehimisht ndalimin e pastrimit të parave dhe konsiderimin e tij si një figurë krimi të pavarur;

-Përcakton disa rregulla për institucionet e kreditit (bankat) ku veçojmë:
a. detyrimin për identifikimin e klientit në momentin e hapjes së llogarisë dhe në rastet e çdo transaksioni mbi shumën 15 mijë ECU (Euro);

b. detyrimin e rritjes së vigjilencës, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që institucionet të kreditit dhe institucionet financiare të shqyrtojnë me vëmendje të veçantë çdo transaksion që ata konsiderojnë si veçanërisht të ngjarë, nga natyra e tij, të lidhura me pastrimin e parave, i cili mbizotëron ndaj parimit të bankave për mosndërhyrje në punët e brendshme të klientit dhe ndaj sekretit bankar;

c. detyrimin e denoncimit në rast dyshimi, duke i ndihmuar autoritetet përkatëse në gjetjen e burimeve të kapitalit;

d. detyrimi i ruajtjes së dokumentacionit sipas të cilit kopje të dokumenteve të identifikimit të klientit dhe të dokumentacionit justifikues të një veprimi bankar, duhet të ruhen për një periudhë kohe të paktën 5 vjet

Vlerësojmë së një element shumë I rëndësishëm në këtë kuadër, për tu vlerësuar nga ana e prokurorëve është Rekomandimi i IX (i posaçëm): korrierët e parasë, zbulimi dhe parandalimi i transportit ndërkufitar të parave cash prej terroristëve dhe kriminelëve të tjerë. Përdorimi i korrierëve të parasë (cash) është njohur tashmë si një metodë kryesore e përdorur prej kriminelëve për të lëvizur fonde. Për këtë çështje, FATF lëshoi Rekomandimin e Posaçëm IX me objektivin për parandalimin e përdorimit të korrierëve të parave cash për pastrimin e kapitalëve kriminale, me objektivin e dhënies së orientimeve për juridiksionet me qëllim zbulimin e tyre dhe për zbatimin e masave efektive për parandalimin e përdorimit

të korrierëve të parave cash prej terroristëve dhe krimeve të tjerë. Kontrabanda e parave është njëra prej metodave kryesore të përdorura prej financuesve të terroristëve, pastruesve të parave dhe anëtarëve të grupeve dhe organizatave kriminale për lëvizjen e parave për të financuar aktivitetet e tyre. Korrierët e parave cash, përdorin metoda të shumta për kontrabandën e parave cash, por metoda më e preferuar e tyre është përdorimi i linjave tregtare të fluturimit. Kalimet e kufirit tokësor ofrojnë gjithashtu avantazhe për korrierin e parave cash, përfshirë aftësinë për të fshehur valutën në mjetin e korrierit. Një metodë tjetër e kontrabandës së parave cash është edhe ajo përmes postës. Ky rekomandim kërkon nga shtetet anëtare të marrin masa të ndryshme që lidhen me vendosjen e rregullave për kufizimin e shumave në sistemin e deklaramit në kufi, jo më shumë se 15 000 Euro, ekspertizë teknike për zbulimin e këtij transporti, identifikimin e korrierëve të parasë cash, konfiskimi i monedhave kontrabandë, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe atij vendas për rritjen e efektivitetit të luftës kundër pastrimit të parave.

Përsa i përket hetimit pasuror, janë trajtuar 44 hetime pasurore. Nga këto, për 6 çështje është vendosur mosfillimi, 2 çështje është pezulluar dhe 1 çështje është transferuar.

Në shërbim të prokurorëve për të ndihmuar në hedhjen e të dhënave në sistemin “Presto” është vendosur specialisti IT, si dhe sekretaret përkatëse. Si rrjedhojë, në sistemin PRESTO janë hedhur gjithë hetimet pasurore, duke përfshirë edhe ato të mbartura nga vitet paraardhëse dhe mbahet i përditësuar çdo fund muaji.

2.1.1 Procedime penale me hetime proaktive dhe veprat penale të rënda:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, i ka kushtuar një rëndësi specifike hetimit proaktiv, hetim i cili në pjesën me të madhe të rasteve është shoqëruar edhe me rezultate të sukseshme që lidhen me arrestimin dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve të veprës penale. Gjatë këtij viti, janë inicjuar një numur i konsiderueshëm rastesh që lidhen me hetimet proaktive por edhe hetime të tjera të thelluara, të cilat kanë kërkuar një nivel bashkëpunimi në rang ndërkombëtar. Hetimet proaktive dhe të thelluara gjatë këtij viti kanë qënë të lidhura kryesisht me veprat penale

që lidhen me narkotikët, kryesisht në formën e trafikimit të narkotikëve, por edhe në rastet e ndihmës së ofruar për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror, rrethanë e diktuar nga rritja e këtyre veprave penale në qarkun e Korçës. Gjatë vitit 2024 janë paraqitur 54 (pesëdhjetë e katër) kërkesa për lejim përgjimi apo zgjatje e afatit të përgjimit, të cilat janë pranuar në 100 % të rasteve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

2.1.2 Masat e marra për mbrojtjen e viktimave të veprës penale ndaj të miturve dhe të dhunës në familje.

Në grupin e veprave penale të cilave ju është dedikuar një rëndësi specifike nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë është edhe vepra penale e “Dhunës në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

Gjithsej janë trajtuar 221 procedime me 107 të pandehur dhe 64 persona nën hetim, nga të cilët 143 procedime me 45 të pandehur dhe 61 persona nën hetim janë regjistruar gjatë vitit 2024. Hetimi ka përfunduar për 117 procedime, ku 89 prej tyre me 95 të pandehur janë dërguar me kërkesë për gjykim. Gjykata ka përfunduar gjykimin për 78 të pandehur dhe 45 prej tyre, ose 58%, janë dënuar me burgim.

Ndryshe ka ndodhur me masat e sigurimit. Janë gjykuar 81 persona me masë sigurimi për veprën penale të dhunës në familje gjatë vitit 2024. Prokurori ka kërkuar arrest në burg për 89% të rasteve dhe Gjykata ka vendosur masën e sigurimit arrest në burg për 62 persona, ose në 77% të rasteve.

Referuar impaktit dhe pasojave të drejtpërdrejta, të dukshme, por edhe atyre të cilat nuk mund të vlerësohen në çastin e parë të referimit të veprës penale, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike hetimit të kësaj vepre penale. Njëkohësisht edhe masat e dënimit të kërkuara nga ana e Prokurorisë, por edhe qëndrimeve të mbajtura nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kanë konfirmuar vlerësimin maksimal që I është bërë seriozitetit dhe rrezikshmërisë së kësaj vepre penale. Gjithsesi, përbën fakt të pranuar tashmë se referuar edhe mekanizmave të referimit të ngritura si të tilla në nivel rajonal nga ana Bashkisë Korçë, rastet e denoncimit të këtyre veprave penale, qoftë edhe

në format e tyre me të lehta janë shumë herë më të larta në raport me qytetet e tjera.

Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, i cili synon të nxisë një zbatim uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që lidhen me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale; të ndihmojë në garantimin e të drejtave që u njihen viktimave të veprave penale dhe ofrimin e shërbimeve që u takojnë atyre me ligj; të parandalojë viktimizimin e përsëritur dhe riviktimizimin e viktimave që vijnë në kontakt me prokurorinë dhe të pakësojë ndikimin traumatizues të pjesëmarrjes në procesin penal. Më tej, udhëzimi nr.17, datë 23.12.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm “Për hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje”, ka për synim të plotësojë kuadrin ligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktimën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 17, datë 23.12.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë “Për hetimin dhe ndjekjen efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtjeje” në vijim të udhëzimit nr.5 datë 26.10.2018. Në këtë udhëzim parashikohen edhe të drejta procedurale që i njihen viktimës së veprës penale, ndër të cilat: në çështjet e dhunës ndaj grave, përcaktohet roli i prokurorit për të vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet e viktimës dhe t’ia shpjegojë asaj; në rastet e dhunës me bazë urrejtje, prokurori duhet të bëjë pjesë të pranimi të fajësisë faktin se vepra është kryer e shtyrë nga motive diskriminuese, në rast se viktimë ka ngritur padi civile, prokurori ka detyrimin që ta informojë se masa e shpërblimit të dëmit do të jetë pjesë e marrëveshjes së fajësisë. Kreu II i këtij udhëzimi i kushtohet formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Duke ju referuar dispozitave të Kodit Penal dhe Konventës së KiE-së “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” format e saj përfshijnë: dhunën fizike, dhunën psikologjike, përndjekjen, dhunën seksuale, martesën e detyruar, ndërprerjen e shtatzënisë, ngacmimin seksual, sterilizimin dhe gjymtimin e organeve gjendore. Megjithatë, sterilizimi dhe gjymtimi i organeve gjendore, nuk parashikohet

si vepër penale me vete, por konsiderohet si vepër penale ndaj shëndetit, të kryera me dashje, me pasoja dëmtim të përhershëm ndaj shëndetit të viktimës, në rrethanën rënduese: “kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë. Kuvendi i Shqipërisë, kanë qenë aktivë në rekomandimin e mbrojtjes më të mirë të grave dhe vajzave, parandalimin e dhunës në familje, hetimit efektiv dhe ndjekjes penale të autorëve të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve.

Krime seksuale. Janë trajtuar gjithsej 39 procedime penale në hetim. 16 prej tyre janë përfunduar. Janë dërguar me kërkesë për gjykim 10 procedime me 11 të pandehur dhe së bashku me çështjet e mbartura në gjykim shkojnë në 18 çështje me 20 të pandehur. Gjykimi ka përfunduar për 11 të pandehur, 7 prej të cilëve kanë marrë dënim me burg.

Trajtimi procedural dhe etik i viktimave: Për veprën penale të dhunës në familje ka pasur gjithsej 5 viktima të mitur (5 femra), ndonse numri i përgjithshëm i viktimave ka qenë 20. Ndonëse për viktimat e mitura do të flasim më poshtë, theksojmë se për sa i takon përmirësimit të aftësive profesionale të prokurorëve, por edhe oficerëve të policisë gjyqësore, në vështirësi edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale

Referuar edhe qëndrimeve të ndryshme të mbajtur nga prokurorë të ndryshëm sa i takon çështjes së identifikimit të saktë të viktimave dhe specifikisht rasteve kur do të duhet të referohemi trashëgimtarëve të viktimave neni 37 I këtij udhëzimi, ka qenë mjaft efikas dhe është sjellë në vëmendje të vazhdueshme të prokurorëve në mbledhjet tematike të organizuara nga kjo prokurori. Ndërkohë që neni 43 I këtij udhëzimi i ka dhënë një orientim që duhet patur në vëmendje nga gjithë trupa e prokurorëve lidhur me mënyrën se si duhet proceduar për të njoftuar viktimat që banojnë jashtë territorit apo viktimave me shtetasi të huaj.

Pjesë e rëndësishme e këtij udhezimi janë edhe gjashtë shtojcat, të cilat I janë vënë dispozicion të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore si modele me të cilat duhet të operojnë në rastet e nevojshme.

Përpos respektimit të udhezimit të Prokurorit të Përgjithshëm, apo ligjit procedural penal sa i takon të drejtave të viktimes, ajo që besoj ben diferencën në Prokurorinë e Korçës është roli shumë i rëndësishëm e koordinatorit të viktimave, e cila përveç se mbulon asistencën ndaj viktimave në këto grupe vulnerabël kryesisht të mitur dhe gra, mban dhe raporton në mënyrë periodike të dhënat statistikore për viktimat pranë Prokurorisë Përgjithshme, kryen dhe një funksion përtej asaj që është përtej detyrimit ligjor. Koordinatori i viktimes në prokurorinë e Korçës është pjesë e grupeve multidisiplinare dhe ka ushtruar një rol kyç edhe në drejtim të rehabilitimit të viktimes si në aspektin financiar, strehimit apo edhe mbështetjes emocionale falë një bashkepunimi shumë të mirë që kemi ndertuar me fondacione dhe shoqata që kanë objekt të veprimtarisë së tyre këtë mision.

Nga ana ime është krijuar një ambjent i posaçëm ku ushtron funksionet koordinatorja për subjekte me status të posaçëm. Ky është një ambjent që vecanërisht i është dedikuar të miturve në konflikt me ligjin dhe është arregtuar në mënyrë miqësore dhe shumë bashkëkohore për këtë kategori.

2.1.3 Treguesit e masave të sigurimit në zbatim të udhëzimit nr. 7/2024.

Gjatë vitit 2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë referuar në funksion të procedimeve penale të regjistruara 527 raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar, krahasuar me 489 në vitin paraardhës. Në 2 raste është vendosur lirim i menjëhershëm i të arrestuarit. Të gjitha rastet e tjera janë dërguar në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë apo ndalimi. Në 4 raste arresti është vlerësuar i paligjshëm. Është kërkuar nga prokurori në 267 raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” dhe në 51 raste “arrest në shtëpi”. Gjithashtu në 186 raste prokurori ka kërkuar masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në oficeri i policisë gjyqësore. Kërkesa për “arrest në burg” është

pranuar nga gjykata në 229 raste. Në 58 raste gjykata ka dhënë masën “arrest në shtëpi”, në 3 raste “garanci pasurore dhe për rastet e tjera gjykata ka caktuar si masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Në 21 raste prokurori ka kërkuar masë ndaluese dhe gjykata e ka pranuar.


Nëse do të analizonim të dhënat që lidhen me masen e sigurimit “arrest në burg”, që është dhe masa ekstreme e sigurimit, në raport me masat e tjera të sigurimit konstatohet se Prokuroria e ka kërkuar këtë masë në 51 % të rasteve, ndërkohë që gjykata e ka miratuar këtë kërkesë në 44 % të tyre. Njëkohësisht konstatohet se vetëm në tre raste, gjykata ka dhënë masë sigurimit “garanci pasurore”, e parashikuar nga neni 236 e K.Pr.Penale.

Në këtë situatë, kur në fund të muajit dhjetor 2023, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Drenovë, ishte në tejkalim të kapaciteteve të veta, dhe transferimit i të paraburgosurve është bërë në IEVP-në, Berat, vlerësoj se trupa e prokurorëve duhet të tregojë një kujdes të shtuar sa i takon kërimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, në përputhje edhe me kushtet dhe rrethanat e secilit prej rasteve objekt hetimi. Konkludojmë për këtë fakt edhe për shkak të vendimit të Strasburgut, Hysa kundër Shqipërisë, i cili ka marrë tashmë formë të prerë në datën 21.05.2023, ku Gjkata ka arritur në përfundimin se gjykata vendase nuk kanë dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimet e tyre lidhur me paraburgimin, i cili i referohet një personi të dënuar femër, për veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar nga neni 248 e Kodit Penal.

Treguesit e masave të sigurimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Totali i arrestimeve/ ndalimeve	Lirim menjëhershëm Neni 257	Kërkesa e prokurorisë Neni 258	Vendimi i gjykatës Neni 259
527	2	525	525
Vleftësime të ligjshme		525	521

Vleftësime të paligjshme		0	4
Arrest në burg		267	229
Arrest në shtëpi		51	58
Detyrim paraqitje		186	214
Garanci pasurore		0	3
Masa ndaluese		21	21



Për të vlerësuar më mirë polikën penale të ndjekur në drejtim të masave të sigurimit, i adresohemi tabelës së mëposhtme:

Lloji i masës së sigurimit	Neni 130/a		283-283/a		Neni 298		100-108/a	
	Prok.	Gjyk.	Prok.	Gjyk.	Prok.	Gjyk.	Prok.	Gjyk.
Arrest në burg	72	62	54	50	15	11	5	5
Arrest në shtëpi	1	5	4	8	0	3	3	3
Detyrim paraqitje	8	14	2	2	1	2	1	1
Garanci pasurore	0	0	0	0	0	0	0	0

Treguesit e masave të sigurimit, referuar edhe qëndrimeve që ka mbajtur gjykata, flasin për një politikë objektive të ndjekur nga prokuroria në lidhje me caktimin e masave të sigurimit. Kujdes i veçantë është treguar në rastet kur personat e dyshuar kanë qënë të mitur, pasi në lidhje me ta, veç moshës janë mbajtur parasysh edhe rrethana të tjera shoqërore e sociale për të qënë sa më objektiv e të kujdesshëm në caktimin e masës së sigurimit. Gjithsej

janë kërkuar 20 masa sigurimi për të mitur. Gjykata ka dhënë për 5 të pandehur masën “arrest në burg” dhe për 8 të tjerë masën “arrest në shtëpi” dhe për 7 të tjerë “detyrim paraqitje”. Masa e sigurimit “arrest në burg”, ndaj të miturve është kërkuar vetëm në rastin e veprave penale të rënda, ose në rastin kur ata janë përsëritës në kryerjen e veprave penale. Gjithsesi referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vlerësoj se trupa e Prokurorëve duhet të jetë me e kujdesshme sa i takon kërkesave që lidhen me masat e sigurimit “arrest në burg”, duke lexuar kështu rast pas rasti edhe standartin që vendos apo orienton Gjykata me vendimarrjen e saj.

2.1.4 Lidhur me krimet kibernetike:

Për veprën penale të fallsifikimit kompjuterik parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal, janë trajtuar 13 çështje: 7 të mbartura dhe 5 procedime penale të reja. Nga këto janë përfunduar 3 çështje, një prej të cilave është dërguar për gjykim me 2 të pandehur dhe nuk ka përfunduar gjykim.

Për veprën penale të mashtrimit kompjuterik parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal, janë trajtuar 9 çështje penale. Ka përfunduar hetimi në 4 çështje. Nga këto 2 çështje me 2 të pandehur janë dërguar me kërkesë për procesi i gjykimit vazhdon.

Janë trajtuar 2 çështje për veprën penale **“Hyrja e paautorizuar kompjuterike”** parashikuar nga neni 192/b i Kodit Penal, nga të cilat një çështje është pezulluar dhe tjetra është në hetim.

Përsa ju përket veprave penale të trajtuara nga neni 293/b, **“Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”**, janë regjistruar 3 çështje, që vazhdojnë të jenë në hetim.

2.1.5 Masat e mara mbi zbatimin e angazhimeve në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian, rekomandimeve të dala nga raportet e Organizatave Ndërkombëtare.

Prokuroria Korçë i ka kushtuar takimeve të organizuara me struktura pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, me qëllim verifikimin e hapesires së duhur procedurale, për të rrifilluar hetime për ngjarje të rënda të pazbuluara si dhe intensifikimin e punës në drejtim të pastrimit të produkteve të veprës penale apo procedimeve pasurore.

Në veshtrim të rritjes së bashkëpunimit me policinë gjyqësore, përmirësimit të përdorimit të metodave speciale të hetimit, prokuroria i ka kushtuar një rëndësi specifike rolit fillestar që ka policia gjyqësore në këtë aspekt, duke siguruar në një numër të konsiderueshëm rastesh trajnime me oficerëve të policisë gjyqësore në drejtimin e një prokurori të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ky bashkëpunim ka qënë një nevojë specifike, në kushtet e ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale, ndëkohë që i është vënë theksi veprave penale që lidhen me posedimin e lëndëve narkotike apo edhe krimeve me ndikim të lartë në shoqëri.

Sa i takon bashkëpunimin me Institucione të tjera ligjzbatuese, duhet përmendur fakti që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike bashkëpunimit me të gjitha agjensitë ligjzbatuese vendase, por edhe të huaja në funksion të administrimit të të dhënave fillestare për hetimin e çështjeve penale, por edhe në trajtimin e tyre si aleatë në hetimin e çështjeve penale me rëndësi thelbësore për luftimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, hetimin financiar, etj.

Megjithatë është shumë e rëndësishme që në fokus të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të vlerësohet me vëmendje specifike përpos punës së tyre të përditshme hetimore edhe nevoja për të organizuar në mënyrë me të shpeshtë takime të përbashkëta të organizuara në nivel kombëtar, por edhe rajonal, pasi shkëmbimi i praktikave më të sukseshme hetimore do të shërbente hetimit të veprave penale që lidhen me krimin e organizuar, korrupsionin, hetimin financiar, evazionin fiskal apo krimin kibernetik.

Nga ana e Prokurorisë Korçë janë organizuar takimeve të punës dhe analizave dhe për çështje të vecanta me shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit, SHKBB, SHISH, si dhe janë zhvilluar edhe trajnime me oficerët e policisë gjyqësore kryesisht të policisë së shtetit përsa i takon përsosjes së protokolleve me të mira të hetimit si dhe të modeleve se si duhet të përpilohen aktet procedurale.

Një nga masat që doja të nenvizoja është bashkepunimi me shume organizata nderkomberare që operojne ne Shqiperi, por edhe seminare te organizuara nga Ambasada Hollandeze, e cila ka gjetur nje teren shume te pershtatshem per te organizuar seminare jo vetem per prokurore dhe oficer te policise gjyqësore por edhe seminare te tjera që lidhen me zbatimin e ligjit në objektin e Prokurorisë Korçë.

2.1.6 Masat e marra mbi zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit.

Sa i takon masave të marra per zbatimin e rekomandimeve te tjera ne Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisëduke ju referuar pikërisht kësaj rezolute, Drejtuesi i prokurorisë, gjithashtu, në kuadrin e masave që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare, kanë parë si prioritet:

a) të jenë aktiv në fillimin kryesisht të procedimeve/hetimeve, verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke monitoruar në veçanti, afatet procedurale, rritjen e efektivitetit të plotshmërisë së hetimeve, si dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor;

b) të zhvillohen mbledhje tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore të caktuar për ecurin në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;

c) të nxjerrin urdhra për policinë gjyqësore që kanë në juridiksion lidhur me ushtrimin e funksioneve në kuadër të luftës kundër veprave penale prioritare të rekomanduara;

ç) të mbështesin punën e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve nepërmjet menaxhimit të duhur të burimeve njerëzore dhe logjistike në

dispozicion, si dhe për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur për të siguruar aksesin për persona me paaftësi fizike dhe pritjen e publikut, sipas prioriteteve të rekomanduara;

d) të koordinojnë me efikasitet veprimtarinë me prokuroritë e tjera kur kjo kërkohet në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara;

Njëkohësisht në kuadër të prioriteve, vlerësohet vijimi i punës për përmirësimin e sistemit elektronik (SVHOPGIP) dhe vënien e tij në funksionim të plotë për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe për monitorimin periodik dhe ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë së tyre në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2021, datë 30.12.2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, i ndryshuar, duke evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.

Lidhur me rekomandimin që të rritet numri i hetimeve proaktive, përdorimi i teknikave të veçanta të hetimit dhe zhvillimi i përdorimit të teknikave të reja, si orientim specifik mund të themi se në vëmendje të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka qënë gjithmonë nxitja e rritjes së numurit të rasteve të cilat do të nënshtrohen hetimeve proaktive dhe hetimeve të thelluara, të cilat kërkojnë gjithmonë një forcim të bashkëpunimit veçanërisht të rëndësishëm me Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, por edhe me strukturat e tjera ligjzbatuese. Gjatë këtij viti, janë inicjuar një numur i konsiderueshëm rastesh që lidhen me hetimet proaktive por edhe hetime të tjera të thelluara, të cilat kanë kërkuar një nivel bashkëpunimi në rang ndërkombëtar. Hetimet proaktive dhe të thelluara gjatë këtij viti kanë qënë të lidhura kryesisht me veprat penale që lidhen me narkotikët, kryesisht në formën e trafikimit të narkotikëve, por edhe në rastet e ndihmës së ofruar për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror, rrethanë e diktuar nga rritja e paprecedentë e këtyre veprave penale në qarkun e Korçës.

Sai takon rekomandimit që të rritet numri i kërkesave për inspektime tematike në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligji gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal.

Në këtë drejtim, të identifikohen nga ana e drejtuesve shkelje të udhëzimeve të përgjithshme, në këtë aspekt, Prokuroria e Korçës ka vlerësuar shumë të rëndësishme bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal.

Raportet e Inspektimeve tematike kanë qënë objekt i diskutimeve në mbledhjet me Prokurorët, jo vetëm në drejtim të njohjes dhe zbatimit të unifikuar të tyre, por edhe në drejtim të përshtatjes me të mirë me veprimtarinë e punës së përditshme të Prokurorisë. Në kushtet, kur nuk ekziston një praktike e unifikuar sa i takon modaliteteve të sakta apo të gabuara të zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, inspektimet marrin një vlerë të shtuar në këtë aspekt. Përkundrazi në këto rrethana vlerësoj duhen nxitur inisjativat për inspektime tematike të cilat do të shërbejnë me së shumti punës së Prokurorisë.

Përpos nxjerrjes së udhëzimeve, me qëllim lehtësimin e zbatimit të Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, zbatimit të rezolutave të Kuvendit apo rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, por edhe mbikqyrjes së zbatimit të tyre nëpërmjet një korrespondence periodike me Prokurorin e Përgjithshëm, unë vlerësoj se në terma teknike dhe konkrete Prokuroria e Korçës ka qënë shumë efektive në implementimin e këtyre orientimeve prioritare.

Koordinimi edhe bashkëpunimi shumë efikas edhe me struktura ndërkombëtare, në kuptim të shkëmbimit në kohe reale të informacioneve të vlefshme për një hetim transnacional në fabrikimin e pasaportave të falsifikuara nga e gjithë bota, përgjatë vitit 2024 të Prokurorisë Korçë ishte një lloj testi që konfirmoi besueshmërinë në Institucionit tone dhe tregoi

mbi te gjithë efijence ne nivel te barabarte me homologet ne hetimin e ne krimi me natyre transnacionale.

2.1.7 Sa i takon masave të marra per rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjes penale, ashtu dhe për rezultatet e arritura me treguesit për numrin e akteve, çështjeve të kaluara për kompetencë sipas veprave penale dhe fazave të procedimit, në zbatim të këtij objekti, udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023, rekomandimeve në Rezolutën e Kuvendit dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, rekomandimeve prioritare të KM dhe planit të veprimit për zbatimin e tyre, si dhe "Aktit të koordinimit ndër-institucional" mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr. 8126, miratuar më datë 15.12.2020, mund të themi se nga është treguar një kujdes i veçantë në këtë aspekt.

Përpos bashkëpunimit institucional dhe në përputhje me ligjin procedural penal me Prokurorinë e Posaçme të Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, në raste me vlerë për hetimin, bashkëpunimi ka qënë edhe i menjëhershëm për të raportuar situata procedurale të cilat mund të nënshtroheshin një hetimi në dinamike. Madje mund të themi se falë këtij bashkëpunimi, është bërë e mundur edhe finalizimi me sukses i hetimit të një dosje penale e dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila është shoqëruar edhe me marrjen e masave të sigurimit ndaj disa të dyshuarve.

Në vështrim edhe të Udhëzimit nr. 2/2023 të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë masat e nevojshme administrative në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në prokurori si dhe mbikqyrje e thelluar lidhur me hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS, në të gjitha fazat e procedimit penal. Njëkohësisht është nxitur bashkëpunimi me agjensitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të veprave penale prioritare të

rekomanduara, veçanërisht ato që lidhen me korrupsionin, trafikimin e narkotikeve, veprat penale kundër mjedisit, krimet kibernetike etj.

Në fokus të drejtimit të Prokurorisë ka qënë edhe mbikqyrja e përditësimit dhe plotshmërisë së të dhënave për procedimet e pastrimit të parave, nëpërmjet sistemit elektronik e-tracking PRESTO.

Po aq kujdes është treguar në kuptim të marjes së masave për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të përmbushur rekomandimet e Moneyval-it dhe FATF-SË, në kuadër të zbatimit të udhëzimit nr. 10/2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave e krimet financiare dhe financimin e terrorizmit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Pikërisht në këtë kuadër nga ana e Drejtuesit krahas nxjerrjes së udhëzimeve që lehtësojnë zbatimin e udhëzimit “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në mbledhjet e zhvilluara me trupën e prokurorëve është treguar kujdes në drejtim të nxitjes së rritjes së numurit të çështjeve të rregjistruara kryesisht, duke u fokusuar tek veprat penale të rekomanduara si dhe në drejtim të respektimit të të drejtave të subjekteve të procedimit penal.

Njëkohësisht drejtuesi I prokurorisë ka qënë veçanërisht i kujdesshëm në drejtim të menaxhimit të burimeve njërezore, aksesit të koordinatorit në të gjitha komitetet e bashkëpunimit dhe asistencës, duke patur në fokus zbatimin me efikasitet të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

2.1.8 Masat e marra në drejtim të zbatimit të urdhërit penal, marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe gjykimit të drejtpërdrejtë.


Në mbledhjet e zhvilluara nga ana e trupës së prokurorëve, është diskutuar dhe inkurajuar secili prej tyre në aplikimin e instituteve të reja të poshtëshënuara me qëllimin përveç të tjerave edhe për të garantuar gjykime sa më efikasitet në kohë në një periudhë kohe kur në fakt, kjo lloj efikasitet ndihmon në mënyrë të konsiderueshme trupën e reduktuar të prokurorëve në këtë Prokurori.

Urdhëri penal: Gjatë vitit 2024, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, janë dërguar për miratim të urdhërit penal 11 çështje penale me 11 të pandehur. Bashkë me çështjet e mbartura në gjykim për miratim urdhëri, ky numër shkon në 25 çështje me 26 të pandehur. Nga këto Gjykata ka miratuar urdhërin në 17 çështje me 18 të pandehur. Gjykata ka kthyer aktet në 6 çështje me 6 të pandehur, nga të cilat 2 janë pushuar për kundërvajtje penale dhe 4 janë në hetim.

Gjykimi me marrëveshje: Në gjykatë janë depozituar 2 çështje me 2 të pandehur për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, që shkojnë në 7 çështje me 7 të pandehur së bashku me çështjet e mbartura në hetim. Në 3 raste Gjykata ka miratuar marrëveshjen dhe të tjerat mbeten në gjykim.

Gjykimi i drejtpërdrejtë: Janë dërguar për gjykim të drejtpërdrejtë 3 çështje me 3 të pandehur. Prokuroria ka aplikuar një nga gjykimet e posaçme sikurse është gjykimi i drejtpërdrejtë kryesisht në veprën penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Grafiku i çështjeve në gjykim



2.1.9 Udhëzimi 5/2024 lidhur me rekomandimet prioritare “Per rekomandimet prioritare për vitin 2024.

Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.5 datë 16.05.2024 "Per rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" dhe urdhrit nr.53, datë 16.05.2024 "Per miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024", të percjella me shkresën nr.622/3

date 17.05.2024, ne cilesine e autoritetit qe mbikqyr zbatimin e ketyre rekomandimeve dhe kujdeset per ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore te prokurorise, krahas vëmëndjes për veprat penale të rekomanduara nga Këshilli i Ministrave, vlerësoj se ka patur një koordinim të veprimtarise me prokurorite e tjera per ceshtje konkrete qe lidhen me fushat, drejtimet prioritare të rekomanduara, dhe koordinimi, bashkepunimi me Prokurorine e Posacme për të gjitha rastet që kanë qënë objekt i procedimeve që mund të kene qënë kompetencë tokësore e prokurorive të tjera apo kompetencë lëndore e Prokurorisë së Posaçme.

Sa i takon numrit dhe menyra e disponimit per hedhjen e shortit elektronik te ndarjes se ceshtjeve ne prokurori nepermjet sistemit CAMS, dhe te ndarjes eshtjeve jashte ketij shorti vlerësoj se sa i takon këtij aspekti, nga ana ime është respektuar në mënyrë rigoroze parashikimi ligjor për shortin elektronik. Materialet e vetme që nuk i janë nënshtruar shortit elektronik janë rastet që lidhen me arrestimet në flagrancë, ndalimet, apo materialet e referuara në kuadër te memorandumit me Ministrinë e Brendshme, të cilat nuk i nënshtrohet sistemit elektronik CAMS.

Por edhe në rastet e sipercituara, pra të arresimeve apo ndalimeve, kriteret për përzgjedhjen e prokurorit nuk ngelen subjektive, në diskrecionin e titullarit të Institucionit, por i refehen ne menyre rigoroze listes së gadishmërisë së nxjerë paraprakisht. Të dyja format e mësipërme të përzgjedhjes së prokurorit që do të ngarkohet me hetimin e nje çështje penale vijnë në vlerësimin tim, si kriteret me objektive të respektimit të figurës së magjistratit si premise e pavarësisë së tij por edhe në tërës si element i garantimit dhe paanshmërisë në sistemin e Drejtësisë. Përvec rasteve të mësipërme, vetëm në rastet e transferimit, komandimit, dorëheqjes, daljes në pension të prokurorëve, materialet e dorëzuara prej tyre i janë nënshtruar ri-shpërndarjes përmes shortimit manual, pasi sistemi CAMS nuk e mundëson ri-shortimin e elektronik të procedimeve penale të cilat janë hedhur njëhere për short. Edhe në këto raste, procesi ka qënë transparent edhe procedura e hedhjes së shortit manual është bërë gjithmone edhe vetem ne prezencën e të gjithë prokuroreve që janë pjese e shortimit. Në rregulloren e institucionit, janë përcaktuar modalitet dhe detyrat e secilit prej punonjësve në zyrën e regjistrat që merren me shortimin, hedhjen e tyre në sistem elektronik dhe në regjistrat përkatës dhe më pas bëhet shpërndarja e materialeve tek secili prokuror kundrejt nënëshkrimit në rregjistrat përkatës. Një element të cilit i është treguar një vëmëndje e shtuar është edhe përditësimi në sistemin PRESTO nga ana e prokurorëve që ndjekin veprat penale që përfshin ky sistem. Në focus të veprimtarisë së Drejtuesit kanë qënë marrja e masave konkrete per monitorimin e sistemeve elektronike PRESTO, SVHOPGJP, platformen elektronike per raportimin e te dhenave per korrupsionin dhe krimin e organizuar per BE-ne, si dhe per kerkimin e vazhdueshem nga prokuroret apo personat e autorizuar prej tyre, per te siguruar hedhjen e te dhenave te plota dhe perftimin e te dhenave statistikore te sakta per ceshtjet e pastrimit te parave, hetimeve financiare ose procedimeve/hetimeve pasurore paralele, (masave te denimeve penale, sekuestrimeve apo konfiskimeve produkteve kriminale ose vlera ekuivalente. Nëpërmjet nje udhezimi të përgjithshëm datë 01.05.2024 “Për

përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave është caktuar zv/Drejtuesi I Prokurorisë së bashku me një person tjetër përgjegjës për të garantuar mbarëvajtjen e hedhjes së të dhënave dhe I gjithë procesi ka qënë efikas sa I takon rezultateve të arritura.

Për të garantuar sukses në drejtim të rritjes së performancës sa i takon numri i rasteve të kerkimit nga prokurorët apo punonjësit e tjerë në prokurori për të koordinuar me zyren/nepunësin e regjistratit për të pasqyruar pa vonesë në regjistrat perkates në ecurinë e ceshtjeve në fazën e hetimit, seances paraprake dhe të gjykimit themelit, dhe për mbikeqyrjen në vazhdimësi, saktësinë e të dhënave të regjistruara, administruara dhe perditesimin e tyre, nga ana ime si Drejtues janë marrë të gjithë masat e nevojshme për të realizuar një ndarje funksionale të detyrave. Dërgimin në afat të të dhënave statistikore në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe jo vetëm, që lidhen me drejtimet prioritare të rekomanduara si dhe me progresin e integritetit të vendit ka qënë një veprimtari e cila lene nën kontrollin primar të Kancelarit të Institucionit dhe mandej kontrolli final I monitorimit të hedhjes së të dhënave është vlerësuar nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë.

2.1.10 Masat administrative dhe procedurale të marra nga drejtuesi i prokurorisë në zbatim të ligjit dhe udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm ose akteve të tjera normative, të shoqëruar me të dhëna/tregues dhe me shpjegime për angazhimet, arritjet dhe problematikat e evidentuara në zbatimin e tyre, si dhe për mënyrën si është proceduar nga secili drejtues, duke përshkruar:

-numrin e udhëzimeve të përgjithshme të nxjerra kryesisht nga drejtuesi ose të nxjerra për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe lloji i tyre (administrativ dhe/ose procedural).

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka disponuar me nxjerjen e disa udhëzimeve të përgjithshme. Kështu është vlerësuar nxjerja e një udhëzimi për zbatimin e ligjit nr 33/2024 “Për dhënie amnistie”. *Ky udhëzim ka patur qëllim të sigurojë zbatimin e njejtë të ligjit për perjashtimin nga ndjekja penale në hetimet paraprake dhe në gjykim, si dhe ekzekutimin e vendimeve penale ndaj personave që perfitojnë nga amnistia e miratuar me ligjin nr. 33/2024 "Për dhënie amnistie.*

Njëkohësisht përgjatë vitit 2024 është disponuar me nxjerjen e një "Udhëzim i përgjithshëm për masat e sigurimit. Qëllimi i këtij udhëzimi është që nepermjet

dhenies se orientimeve te qarta per prokuroret e prokurorive prane gjykatave me juridiksion te pergjithshem, per zbatimin e standardeve ligjore qe balancojne nevojen per siguri te personit dhe publikut dhe efektivitetin e ndjekjes penale, me domosdoshmerine per te respektuar lirate dhe te drejtat e njeriut.

Në fokus të veprimtarisë së prokurorisë, në përshtatje edhe me nevojat për raportime periodike dhe efikase në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe transparencës për luftën ndaj krimit të organizuar, është vlerësuar e rëndësishme nxjerja e një udhëzimi të përgjithshëm për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Platforma elektronike, shërben për Raportimin e të Dhenave për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar krijuar nga Komisioni Europian për të mbledhur dhe raportuar në mënyrë konsistente dhe të plote të dhënat lidhur me historikun e ndjekjeve dhe denimeve penale për veprat penale të rënda lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Në Prokurorinë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, Korçë drejtuesi cakton dhe autorizon zv/Drejtuesin e Prokurorisë dhe një sekretare me eksperiencë si personat përgjegjës dhe përdorues, që do të hedhin dhe do të përditesojnë në mënyrë periodike të dhënat në Platformën Elektronike.

Përdoruesve ju është siguruar akses në Platformën Elektronike nga Komisioni Europian me emrin e përdoruesit, numrin e telefonit dhe fjalëkalimin përkatës, në përputhje me kredencialet personale të secilit prej tyre.

Drejtuesi I Prokurorisë ka marrë të gjitha masat që përdoruesit e Platformës Elektronike të tregojnë kujdes në hedhjen e të dhënave përkatëse në sistem duke mos e demtuar teknikisht ato.

Në rastet kur punonjësit e autorizuar për akses në këto platforme do të ndryshohen, Drejtuesi njofton menjëherë Prokurorinë e Përgjithshme, e cila i kërkon Ministrisë së Drejtësisë bllokimin e kodeve hyrës për punonjësin përkatës dhe pajisjen me kredenciale të punonjësit të ri.

Përdoruesit në mbikëqyrjen e drejtuesit hedhin dhe përditesojnë elektronikisht në Platformën Elektronike, fushat e raportimit sipas kompetencës dhe metodologjisë së miratuar.

Njëkohësisht nga ana e Drejtuesit është vlerësuar nxjerja e një Udhëzimi të përgjithshëm për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër trafikimit të personave. Ky udhëzim i përgjithshëm ka patur për qëllim unifikimin

e masave administrative dhe procedurale ne prokurori duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive te krimeve te trafikimit te personave te rritur dhe trafikimit te te miturve, ne afate optimale (shpejta), mbrojtjen eficiente te te drejtave te viktimave te trafikimit dhe mbrojtjen e te drejtave te njeriut, si dhe paraqitjen e kerkesave per masa denimi efektive, proporcionale e frenuese, qe te kontribuojne ne parandalimin e pergjithshem dhe te posacem te autoreve te trafikimit.

Po ashtu është konkluduar në nxjerjen e një udhëzimi lidhur me rekomandimet prioritare ne luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokurorinë Korçë.

Qellimi i ketij udhezimi te pergjithshem eshte zbatimi i rekomandimeve prioritare te Keshillit te Ministrave ne luften kunder kriminalitetit per vitin 2024 ne kompetence lendore te prokurorinë Korçë, pa cenuar pavaresine e prokurorise si organ qe garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarise se saj dhe respekton pavaresine e brendshme te prokuroreve per hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit ndërkohë që është kërkuar informacion për ecurinë e 15 procedimeve penale.

Lidhur me veprat penale që prekin zgjetjet e lira, për vitin 2024 nuk ka pasur vetëm ndonjë procedim penal të regjistruar. Janë trajtuar 4 procedime penale të mbartura:

- Një procedimi ka të bëjë me kallzimin e një subjekti politik, në zgjedhjet vendore të vitit 2023, që akuzon një person tjetër për veprën penale të falsifikimit të materialit zgjedhor, të parashikuar nga neni 326 I Kodit Penal. Procedimi është dërguar për gjykim me 2 të pandehur. Gjykimi nuk ka përfunduar.
- 1 (një) për procedim i regjistruar për veprën penale të votimit më shumë se një herë, parashikuar nga neni 327/a i Kodit Penal, vazhdon të jetë në hetim.
- 1 (një) procedim i regjistruar për veprën penale të detyrimit për pjesëmarrje në veprimtari politike, parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal, vazhdon të jetë në hetim.
- Për një procedim të regjistruar për veprën penale të falsifikimit të materialit zgjedhor, parashikuar nga neni 326 I Kodit Penal, mbartur në gjykim me 4 të pandehur. Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur

kthimin e akteve. Gjykata e Apelit, e vënë në lëvizje nga prokurori, ka vendosur pushimin e akuzës për 3 të pandehur dhe gjykimi vazhdon për një të pandehur.

Në zbatim të Udhëzimit të përgjithshëm nr. 3, datë 29.12.2016 *"Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori"*, i ndryshuar, për hedhjen e shortit elektronik, në periudhën janar-dhjetor 2024, është realizuar në mënyrë shume efikase mbikqyrja e hedhjes së shortit elektronik. Rastet përjashtimore që nuk i janë nënshtruar procesit të hedhjes së materialeve në short janë rastet e arresteve në flagrancë, ndalimeve apo rastet e ngutshme për të proceduar me përgjime apo veprime të tjera proaktive.

Udhëzimit të përgjithshëm nr. 8/2020, datë 19.05.2020 *"Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"* i ndryshuar me udhëzimin nr. 6/2021, datë 23.07.2021, ku në nenin 36 të ndryshuar të udhëzimit parashikohet raportimi periodikisht i shpenzimeve procedurale nga Zyrat e Financës në secilën prokurori në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila përllëgarit kostot e shpenzimeve procedurale penale sipas veprave penale dhe zërave përkatëse për procedimet penale të përfunduara, si dhe vlera/shuma totale e tyre, sipas prokurorive.

Në përputhje me përmbajtjen e Udhëzimit të përgjithshëm nr. 8/2020, datë 19.05.2020 *"Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"* i ndryshuar me udhëzimin nr. 6/2021, datë 23.07.2021, përpos respektimit të ndryshimit që lidhet me raportimin periodik të shpenzimeve procedurale nga Zyrat e Financës në secilën prokurori në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila përllëgarit kostot e shpenzimeve procedurale penale sipas veprave penale dhe zërave përkatëse për procedimet penale të përfunduara, si dhe vlera/shuma totale e tyre, sipas prokurorive, I është kushtuar një vëmendje e shtuar nenit 12 të këtij udhëzimi e që lidhet specifikisht me modalitetet e përcaktimit të kriterëve për përcaktimin e shpenzimeve dhe pagesën e ekspertëve në varësi të shpenzimeve të transportit që varjon deri në 100 ose mbi 100 km.

Udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2020 datë 13.05.2020 *"Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertisë"* për të siguruar konsulta teknike dhe asistencë apo këshillime, mbi kërkesat e prokurorëve, si për procedime apo çështje penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale (doganore e tatimore) dhe auditimit të brendshëm publik, ashtu dhe për procedime apo çështje penale në fushat inxhinieriko-mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore, për të forcuar ligjshmërinë dhe rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale, si ndaj krimit ekonomik e financiar, pastrimit të parave, përfshi dhe hetimet pasurore sipas fushave, ashtu dhe ndaj veprave penale në fushën e qarkullimit, transportit dhe sigurisë rrugore.

Në zbatim të Udhëzimit të përgjithshëm nr. 7/2020 datë 13.05.2020 *"Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertisë"*, Drejtuesi I Prokurorisë I ka kushtuar një rëndësi specifike unifikimit të ushtrimit të funksioneve me efektivitet për të siguruar konsulta teknike dhe asistencë apo këshillime, mbi kërkesat e prokurorëve, si për procedime apo çështje penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale (doganore e tatimore) dhe auditimit të brendshëm publik, ashtu dhe për procedime apo çështje penale në fushat inxhinieriko-mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore, për të forcuar ligjshmërinë dhe rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale, si ndaj krimit ekonomik e financiar, pastrimit të parave, përfshi dhe hetimet pasurore sipas fushave, ashtu dhe ndaj veprave penale në fushën e qarkullimit, transportit dhe sigurisë rrugore nga Shërbimi i Ekspertizës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm lidhur me rekomandimet prioritare *"Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024"*, dhe planit të veprimit për zbatim e këtyre rekomandimeve i miratuar, ku, veç masave të trajtuara më sipër, shpjegimet duhet të jepen të detajuara, për masat e zbatuara sipas secilit rekomandim që përfshihen bazuar në të dhënat me treguesit për vitin 2024, sipas drejtimeve në kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme për të dërguar informacion të përditësuar në gjithë prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe si kanë ndikuar masat e udhëzuara/rekomanduara dhe

zbatuara mbi gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara ose në veprimtarinë administrative të rekomanduar.

Në fokus të planit të mësipërm të veprimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është vënë specifikisht theksi tek masat e mëposhtme:

1. Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit gjatë hetimeve paraprake.
2. Marrjen e masave procedurale dhe administrative për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve, si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit.
3. Vijimin e marrjes së masave për kontrollin nga prokurori të punës së Oficerëve të Policisë Gjyqësore, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë së hetimeve, duke evidentuar rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.
4. Vijimin e masave për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve si për prokurorët ashtu dhe për oficerët e policisë gjyqësore, në përputhje me profilizimin e tyre sipas seksioneve brenda prokurorive, duke mbajtur në konsideratë edhe politikën penale.
5. Vijimin e masave me qëllim arritjen e funksionimit optimal të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm për saktësinë e paraqitjes së këtyre të dhënave.

Në kuadër të zbatimit të këtyre masave, prokurorëve ju është kërkuar:

1. Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafikeve të paligjshme, si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale.
2. Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të

rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, si dhe numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.

3. Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust, si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

4. Marrjen e masave për rritjen e rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore, por dhe në rastet e trafikimit dhe krimit të organizuar.

5. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike.

6. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit me organet ligjzbatuese ndërkombëtare, në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda.

7. Rritjen e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të posaçme në këtë fushë, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me struktura të tjera ligjzbatuese.

8. Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe aseteve të sekuestruara për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale

Treguesit, në zbatim të Udhëzimit të përgjithshëm nr. 4/2024 “Për zbatimin e ligjit 33/2024 për dhënie amnistie”, janë si më poshtë: 7 kallzime u mosfilluan në zbatim të këtij ligji. Gjithashtu 208 procedime penale u pushuan. Nga këto 116 ishin kundërvajtje penale në faze hetimi, 18 çështje ishin të dërguara në gjykatë për pushim dhe 72 çështje ishin të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim. Përsa i përket zbatimit të ligjit mbi amnistinë ndaj personave të dënuar në fazën e ekzekutimit të dënimeve penale, u liruan 207 të dënuar dhe përfituan lirim me kusht apo zbritje dnimi 18 të tjerë.


2.1.11 Analiza e treguesve e ngarkesës për Seksionin e të Miturve gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024 Seksioni i të Miturve ka patur në përbërje të tij tre prokurorë. Janë trajtuar gjithsej 83 të mitur (79 meshkuj, 4 femër), nga të cilat 18 të mitur të mbartur në gjykim, 30 të mbartur në hetim dhe 35 të regjistruar gjatë vitit 2024. Nga këta, 9 të mitur kanë qënë deri në moshën 14 vjeç ditën e kryerjes të veprës penale, 38 të mitur në grupmoshën 14-16 vjeç dhe 36 të mitur në grupmoshën 16-18 vjeç. Gjithsej janë kërkuar 20 masa sigurimi për të mitur. Gjykata ka dhënë për 5 të pandehur masën “arrest në burg” dhe për 8 të tjerë masën “arrest në shtëpi” dhe për 7 të tjerë “detyrim paraqitje”.

Ka përfunduar hetimi për 49 të mitur, në 20 raste është vendosur pushimi për shmangie nga dënimi, në një rast është vendosur pushim për kundërvajtje penale, në një rast gjykata ka vendosur pushimin dhe 27 të mitur janë dërguar me kërkesë për gjykim.

Ka përfunduar gjykimi për 22 të mitur, nga të cilët vetëm 2 janë dënuar me burgim dhe të tjerët me dënime alternative.

Grafiku i mënyrës të përfundimit të hetimeve për të mitur:



Koordinatorja për Subjektet me Status të Posaçëm ka asistuar gjithë të miturit ndaj të cilëve është vendosur pushimi për shmangie nga dënimi (20 raste).

Në vështrim edhe të nenit 10 të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë tre prokurorë magjistratë të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjin nr. 37/2017, “Kodi I Drejtësisë Penale për të mitur”. Prokurororëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për t’u përjashtuar nga pagimi i çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Më ndryshimet e ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 të Kodit të Procedurës Penale, saktësisht nga neni 13/4 të këtij Kodi, prej datës 01.08.2017 në kompetencën e këtij Seksioni, kanë qënë edhe hetimi i veprave me viktima apo të dëmtuar të mitur. Në vijim, në respektim edhe të ndryshime ligjore që lidhen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike “Seksionit për të Mitur”, duke krijuar një Seksion me një numër të shtuar prokurorësh për të miturit, i cili do të ketë edhe mundësinë për t’u trajnuar për të qënë në një qasje sa më korrekte me frymën e Kodit dhe trajtimit të diferencuar të të pandehurit të mitur.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të të drejtave procedurale të të miturve dhe aplikimit të një politike penale favorizuese në përputhje me moshën e tyre. Në të gjitha fazat e procedimeve penale ku si persona nën hetim/të pandehur kanë qënë të miturit nën moshën 18-vjeçare nga ana e organit të prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet në prani të avokatëve mbrojtës dhe në prani të të afërmëve të tyre dhe të psikologëve. Janë respektuar jo vetëm të drejtat procedurale po dhe u është dhënë një trajtim njerëzor në përputhje me moshën e tyre.

Veprat penale për të cilat janë proceduar kryesisht të miturit janë “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K. Penal, “Vjedhja” parashikuar nga neni 134 i K. Penal, gjithashtu, ka patur raste të “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88 i K. Penal dhe “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur nën 14 vjeç”,

parashikuar nga neni 100 i K. Penal, “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i K. Penal.

Në lidhje me masat e sigurimit, nga organi i akuzës është proceduar me hetim në gjendje të lirë të të miturve, për veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore si ajo e parashikuar nga neni 291 dhe 134/1 i K. Penal. Për veprën penale të parashikuar nga neni 283 dhe 134/2, është aplikuar masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Për veprat penale të parashikuara nga neni 88/1, neni 100 i K. Penal, si dhe vepra të tjera me rrezikshmëri të veçantë shoqërore, është proceduar me masë siguri “Arrest në burg”, e cila në rastet e kërkuara, është vendosur edhe nga ana e Gjykatës.

Në lidhje me dënimet e aplikuara, për veprat penale me marzh dënimi në maksimum deri në pesë vjet, është aplikuar shmangia nga ndjekja penale sipas parashikimeve të KDPM. Në rastet kur i mituri në konflikt me ligjin ka rezultuar i dënuar më parë, është proceduar me kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim. Nga Gjykata, këta të mitur janë dënuar me dënim alternativë.

Në lidhje me të miturit viktimë të veprës penale, është treguar kujdes i veçantë për trajtimin e tyre në mënyrë të tillë që të shmanget riviktimizimi. Në pyetjen dhe trajtimin e tyre, janë zbatuar nga organi i akuzës rregullat procedurale me rigorozitet. Të miturit janë paraqitur si viktima kryesisht në vepra penale “Dhunë në familje”, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” dhe “Ngacmim seksual”. Nuk kanë munguar as rastet kur i mituri ka qënë viktimë në veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”.

Hetimi i veprave penale me të mitur, qoftë si autorë të veprës penale apo si viktima, janë trajtuar me përparësi dhe janë përfunduar hetimet duke u dërguar çështjet për gjykim, brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Janë regjistruar gjithsej 20 viktima të mitur (3 meshkuj dhe 17 femra) më së shumti për veprat penale të dhunës në familje dhe të ngacmimit seksual.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktikë është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të

“viktimës”, trashëgimtarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paaftësi fizike apo intelektuale. Referuar edhe qëndrimeve të ndryshme të mbajtur nga prokurorë të ndryshëm sa i takon çështjes së identifikimit të saktë të viktimave dhe specifikisht rasteve kur do të duhet ti referohemi trashëgimtarëve të viktimave neni 37 I këtij udhëzimi, ka qënë mjaft efikas dhe është sjellë në vëmendje të vazhdueshme të prokurorëve në mbledhjet tematike të organizuara nga kjo prokurori. Ndërkohë që neni 43 i këtij udhëzimi i ka dhënë një orientim që duhet patur në vëmendje nga gjithë trupa e prokurorëve lidhur me mënyrën se si duhet proceduar për të njoftuar viktimat që banojnë jashtë territorit apo viktimave me shtetas të huaj. Pjesë e rëndësishme e këtij udhëzimi janë edhe gjashtë shtojcat, të cilat I janë vënë dispozicion të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore si modele me të cilat duhet të operojnë në rastet e nevojshme.

Sa i takon Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”.

Njohja me këtë Udhëzim i ka shërbyer prokurorëve që në zbatim edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale. Në vështrim edhe të nenit 10 të këtij Udhëzimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë tre prokurorë magjistratë të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjin nr. 37/2017, “Kodi I Drejtësisë Penale për të mitur”.

Prokurororëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për tu përjashtuar nga pagimi i çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktikë është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të

“viktimës”, trashëgimtarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paaftësi fizike apo intelektuale.

Më ndryshimet e ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 të Kodit të Procedurës Penale, saktësisht nga neni 13/4 të këtij Kodi, prej datës 01.08.2017 në kompetencën e Seksionit për të Mitur, kanë qënë edhe hetimi i veprave me viktima apo të dëmtuar të mitur. Në vijim, në respektim edhe të ndryshime ligjore që lidhen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike “Seksionit për të Mitur”, i cili ka krijuar nje eksperiencë të konsiderueshme tashme për të patur një qasje sa më korrekte me frymen e Kodit dhe trajtimit të diferencuar të të pandehurit të mitur.

Në rastet kur personi i pandehur ka qënë i mitur, në vëmendjen specifike të Prokurorisë, por edhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka qënë dhënia e alternativave të dënimit me burgim.

Kërkimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, për të dyshuarit e mitur gjatë vitit 2024 është aplikuar në 6 raste raste nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe gjykata e ka dhënë këtë masë në 2 raste.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar respektimit të të drejtave procedurale të të miturve dhe aplikimit të një politike penale favorizuese në përputhje me moshën e tyre. Në të gjitha fazat e procedimeve penale ku si persona nën hetim/të pandehur kanë qënë të miturit nën moshën 18-vjeçare nga ana e organit të prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet në prani të avokatëve mbrojtës dhe në prani të të afërmëve të tyre dhe të psikologëve. Janë respektuar jo vetëm të drejtat procedurale po dhe u është dhënë një trajtim njerëzor në përputhje me moshën e tyre.

Në çështjet me të mitur është patur kujdes që të procedohej me sa më pak raste me arrestime apo ndalime me subjekt procedural të mitur duke i kryer hetimet ndaj tyre në gjendje të lirë dhe me masa sigurimi të lehta si *“Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqësore”* të parashikuar nga neni 234 të K.Pr.Penale. Masa e sigurimit *“Arrest në burg”* të parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale është caktuar vetëm në raste specifike, për të mitur që kanë kryer vepra penale të rënda, ose që kanë qënë recidivisht në kryerjen e veprave penale. Kohëzgjatja e afatit të hetimeve në çështjet me

të mitur ka qenë e shkurtër dhe kryerja e veprimeve hetimore janë kryer në mënyrë të përsheptuar. Në masat e dënimit, Seksioni i të Miturve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka kërkuar për këto subjekte pranë Gjykatës Korçë dënime të lehta dhe aplikimin e dënimeve alternative duke patur parasysh riedukimin dhe riintegrimin e tyre, si dhe parandalimin e kryerjeve të veprave penale nga ta miturit.

Konstatohet se në 20 raste Seksioni për të Mitur ka konkluduar në shmangien nga ndjekja penale dhe është proceduar me aplikimin e nenit 67 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

Njohja me këtë Udhëzim i ka shërbyer prokurorëve që në zbatim edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale. Në vështrim edhe të nenit 10 të këtij Udhëzimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë dy prokurorë magistratë të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjirn nr. 37/2017, “Kodi I Drejtësisë Penale për të mitur”.

Prokurororëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për tu përjashtuar nga pagimi i çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktikë është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të “viktimës”, trashëgimtarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paaftësi fizike apo intelektuale.

2.1.12 Gjatë këtij viti nuk ka pasur kallzime të ardhura nga ILDKPI. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka 6 procedime të mbartura në hetim, një prej të cilave është pushuar dhe të tjerat vazhdojnë të jenë në hetim. Nga Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka vetëm një çështje të mbartur nga viti i kaluar dhe gjykimi ka përfunduar në këtë vit.

Prioritete dhe statistike lidhur me disa nga veprat penale të hetuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Lufta kundër trafikimit të shtetasve:

Gjatë vitit 2024 në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me trafikimin e shtetasve të parashikuara nga nenin 110/a ka pasur një procedim penal të mbartur që është pezulluar, një të rifilluar nga viti 2020 që është dërguar në gjykatë për pushim dhe një kallzim të ri të transferuar në Prokurorinë Elbasan. Sa më sipër rezulton se në lidhje me vepren penale "Trafikim i personave të rritur" të parashikuar nga neni 110/a i K. Penal gjatë vitit 2023 janë hetuar 2 procedime penale dhe një kallzim, pa asnjë person nën hetim, çështje të cilat kanë përfunduar gjatë vitit 2024.

Për nenin 128/b të K. Penal rezulton se janë trajtur 3 procedime penale të mbartura që vazhdojnë të jenë në hetim.

Lufta kundër trafikimit të veprave të artit dhe kulturës;

Gjatë vitit 2024 në lidhje me vepren penale të "Trafikimit të veprave të artit dhe kulturës", të parashikuar nga neni 138/a i K. Penal rezulton se në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë është regjistruar një procedim penal, i cili vazhdon të jetë në hetim. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë nuk është gjykuar asnjë procedim penal.

Lufta kundër trafikimit të mjeteve motorrike:

Gjatë vitit 2024 në lidhje me vepren penale "Trafikim i mjeteve motorrike" të parashikuar nga neni 141/a i K. Penal rezulton se nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë janë referuar 15 materiale

hetimor, nga të cilat 3 janë mosfilluar, 12 materiale më pas janë regjistruar si procedime penale të reja dhe së bashku me 18 procedime të mbartura, e çojnë numrin në 30 procedime të trajtuara.

Gjatë vitit 2024 kanë përfunduar 9 procedime (4 janë pushuar, 4 janë transferuar dhe 1 procedim me 4 të pandehur është dërguar për gjykim). Vazhdojnë hetimet për 21 procedime.

Në lidhje me fazën e gjykimit, në lidhje me veprën penale "Trafikim i mjeteve motorrike" të parashikuar nga neni 141/a i K. Penal rezulton se gjykimi vazhdon në 2 procedime me 5 të pandehur.

Lufta kundër trafikimit të armëve dhe municionit;

Gjatë vitit 2024 në lidhje me veprën penale të "Trafikimit armëve dhe municionit" të parashikuar nga neni 278/a i K. Penal rezulton se në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë nuk ka pasur materiale hetimore të referuara nga policia për vitin 2024.

Janë trajtuar 5 procedime penale të mbartura, nga të cilat një është pushuar, një është pezulluar dhe 1 procedim me 2 të pandehur janë dërguar për gjykim.

Në lidhje me veprën penale "Trafikimit armëve dhe municionit" të parashikuar nga neni 278/a i K. Penal, të hetuara gjatë vitit 2024, nuk ka përfunduar gjykimi në procedimin e vetëm penal që është në process.

Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, prodhimit, shitjes, transportimit, mbajtjes apo trafikimit të lëndëve narkotike:

Gjatë vitit 2024, hetimi dhe përfundimi i çështjeve penale në lidhje me veprat penale kundër narkotikëve që përfshijnë prodhimin dhe shitjen e narkotikëve, trafikimin e narkotikëve dhe kultivimin e narkotikëve ka qenë një nga drejtimet

ku është fokusuar lufta kundër krimit të organizuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me narkotikët rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

Konkretish, gjatë vitit 2024, nga Shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit janë referuar 63 materiale hetimore për neni 283 të Kodit Penal. Nga këto 11 kallzime janë mosfilluar dhe 52 të tjera janë regjistruar procedime penale. Gjithashtu 117 procedime penale janë mbartur nga viti 2023, duke çuar numrin në 169 procedime të trajtuara.

Janë përfunduar 98 procedime penale nga të cilat 35 procedime me 112 të pandehur i janë dërguar Gjykatës me kërkesë për gjykim.

Ka përfunduar gjykimi për 76 të pandehur (një pjesë e tyre të mbartur në gjykim nga viti 2023) dhe gjykata ka vendosur për 54 prej tyre dënim me burg.

Gjithashtu lidhur me veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, të parashikuar nga ne neni 283/a i Kodit penal, ka pasur 33 procedime të mbartura në hetim dhe 5 të referuara nga Policia për vitin 2023. Pra janë trajtuar gjithsej 38 procedime penale.

Ka përfunduar hetimi për 14 procedime dhe janë dërguar në gjyq 4 procedime me 12 të pandehur.

Gjykata gjatë vitit 2024 ka përfunduar gjykimin për 24 të pandehur dhe për 21 prejtyre ka dhënë dënimin me burgim.

Përsa i përket veprës penale të "Kulivimit të bimëve narkotike" (Neni 284 i K. Penal) rezulton se për këtë vepër, për vitin 2024 janë regjistruar vetën 4 procedime penale të reja, që ju bashkohen 12 procedimeve të mbarturanga viti 2023. Bashkë me procedimet e mbartura në hetim janë trajtuar gjithësej 16 procedime penale. 9 prej tyre janë përfunduar dhe 3 çështje me 3 tl pandehur janë dërguar me kërkesë për gjykim. Ka përfunduar gjykimi në një çështje me një të pandehur.

Sa i takon të dhënave për rastet e bashkëpunimit me QKA (Qendrën Kombëtare të Analizës) në Bankën e Shqipërisë, nuk ka patur raste ku të jenë identifikuar dhe sekuestruar sasi të konsiderueshme monedhash të falsifikuara si dhe rastet kur gjatë hetimit janë zbuluar ambjente për prodhimin e monedhave të falsifikuara;

Për të vlerësuar politikën penale të ndjekur në dënimin e disa krimeve, në kuadër të uljes të kriminalitetit, i referohemi tabelës së mëposhtme:

Masa e dënimit	Neni 130/a		283-283/a		Neni 298		100-108/a	
	Prok.	Gjyk.	Prok.	Gjyk.	Prok.	Gjyk.	Prok.	Gjyk.
Burg Mesatar	33	33	49	53	36	38	6	6
Dënim me kusht	32	31	25	22	26	23	1	1
Gjobë	0	0	1	0	0	0	0	0
Pushim akuze	0	0	2	2	3	3	0	0
Pushim çështje	0	0	3	3	1	1	0	0
Pafajsi	0	1	0	0	0	1	0	0

Bashkëpunimi me policinë gjyqësore:

Lidhur me masat e marra nga drejtuesit e prokurorive, në vështrim të rritjes së bashkëpunimit me policinë gjyqësore, përmirësimit të përdorimit të metodave speciale të hetimit, prokuroria i ka kushtuar një rëndësi specifike rolit fillestar që ka policia gjyqësore në këtë aspekt, duke siguruar në një numër të konsiderueshëm rastesh trajnime mes oficerëve të policisë gjyqësore në drejtimin e një prokurori të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ndonëse Prokurori është i ngarkuar me ligj të drejtojë dhe udhëheqë hetimin e çështjes penale, për të menaxhuar në mënyrë të suksesshme ushtrimin efikas të ndjekjes penale, ai duhet të bashkëpunojë me një tërësi hallkash, të cilat në mënyrë të koordinuar do të garantojnë edhe suksesin në menaxhimin e çështjes penale në tërësi.

Kështu ngelet vërtet problem cilësia e hetimit si në përpilimin e akteve ashtu dhe në vlerësimin dhe çmuarjen e provave në momentin fillestar të referimit të një materiali kallzues. Ndryshimet e nenit 293/1 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të sjellin një disiplinim akoma edhe më të madh të policisë gjyqësore, për të referuar brenda afatit prej 72 orësh elementet thelbësore të faktit penal që procedohet, burimin e provës si dhe të dhëna të tjera që kanë rëndësi specifike për referimin e veprës penale. Përpos problemeve që lidhen me vlerësimin e materialit fillestar të referuar në Prokurori, nga ana e policisë gjyqësore kërkohet edhe këtë vit një efikasitet më i madh si në përpilimin e akteve gjatë fazës së hetimit, ashtu edhe në sistematizimin dhe organizimin e punës nga ana e oficerëve, të cilët jo në pak raste janë të organizuar dhe planizuar edhe në shërbime të tjera operative për llogari të Drejtorisë Vendore të Policisë, duke cënuar kështu edhe performacën e policisë gjyqësore në hetim. Nga ana tjetër, një problematike tjetër e konstatuar ka qënë edhe mangësia e theksuar e oficerëve të policisë gjyqësore në disa Komisariate si dhe levizjet e shpeshta të oficerëve, veprim i cili pengon specializimin e tyre për protokolle të veçanta të hetimit.

Bashkëpunimit me Institucione të tjera ligjbatuese,

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kushtuar një rëndësi specifike bashkëpunimit me të gjitha agjensitë ligjbatuese vendase, por edhe të huaja në funksion të administrimit të të dhënave fillestare për hetimin e çështjeve penale, por edhe në trajtimin e tyre si aleatë në hetimin e çështjeve penale me rëndësi thelbësore për luftimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, hetimin financiar, etj. Megjithatë është shumë e rëndësishme që në fokus të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të vlerësohet me vëmendje specifike përpos punës së tyre të përditshme hetimore edhe nevoja për të organizuar në mënyrë me të shpeshtë takime të përbashkëta të organizuara në nivel kombëtar, por edhe rajonal, pasi shkëmbimi i praktikave më të sukseshme hetimore do ti shërbente hetimit të veprave penale që lidhen me krimin e organizuar, korrupsionin, hetimin financiar, evazionin fiskal apo krimin kibernetik. Gjatë vitit 2023 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, që përbën një element shumë të rëndësishëm të

suksesit në punën e prokurorisë. Bashkëpunimi i mirë ka funksionuar si në nivel titullarësh, por edhe në nivelin bazë dhe ka dhënë rezultatet e veta. Theksi është vënë në përmbushjen e detyrimeve të policisë gjyqësore, rritjen e nivelit profesional të tyre, eliminimin e zvaritjeve të pa justifikuara dhe rritjen e cilësisë së hetimit me qëllim për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në këtë rreth.

Ka një përmirësim të bashkëpunimit me pushtetet vendore dhe institucionet e tjera lokale me synimin për të marrë prej tyre në kohë informacionin e nevojshëm në interes të hetimit. Edhe përsa i përket ekzekutimit të vendimeve penale, bashkëpunimi me IEVP dhe Shërbimin e Provës Korçë ka qënë mjaft i mirë.

Përsa i përket marrëdhënieve të punës me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ato kanë qënë korrekte dhe të bazuara në ligj. Ka patur një përmirësim të ndjeshëm të raporteve me këtë gjykatë sidomos për zgjidhjen e problemeve të natyrës administrative.

Me Prokurorinë e Apelit Korçë vazhdojnë të ruhen marrëdhënie të mira institucionale. Kjo prokurori na ka mbështetur në të gjitha kërkesat tona të ligjshme dhe ka orientuar qëndrimin tonë për çështje konkrete.

e) Zbatimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, me tregues dhe me shpjegime për arritjet dhe problematikat në zbatimin e akteve normative.

Një element shumë i rëndësishëm që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë vlerëson si shumë të rëndësishëm edhe në kuadër të zbatimit të Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave është edhe zbatimi dhe analizimi në mënyrë të detajuar i Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, analizën e produktivitetit të tyre po e parashtrojmë si më poshtë :

Në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 26.10.2018, “Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, administruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën me nr. 2881 prot, datë 30.10.2018.

Ky udhëzim është bërë objekt i vlerësimeve dhe diskutimeve në Mbledhjen e Prokurorëve, me qëllim individualizimin e kriterëve dhe trajtimin e rregjimit të diferencuar të sekretit shtetëror në raport me sekretin hetimor.

Në vlerësim dhe zbatim të këtij udhëzimi është treguar një kujdes i shtuar për të gjitha veprimet që lidhen me momentin procedural të hyrjes së dokumentave apo materialit të klasifikuar në Institucion, rregjistrimit të tij në Rregjistrin e Korrespondencës së Informacionit të Klasifikuar dhe mandej dorëzimit të tij kundrejt nënshkrimit.

Punonjësi i ngarkuar me administrimin e Rregjistrit të Korrespondencës së Informacionit të Klasifikuar është trajnuar dhe orientuar për të respektuar modalitetet e marjes në dorëzim të objektit postar sipas nenit 3 të këtij Udhëzimi. Referuar qëndrimeve të ndryshme të mbajtura nga ana e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, por edhe nga Gjykatat e Apelit, në mënyrë specifike, një element, të cilit i është treguar një vëmendje specifike ka qënë neni 7 i këtij Udhëzimi. Nga ana e prokurorëve është kërkuar të kenë një vëmendje të shtuar ndaj detyrimit të mospërfshirjes së informacioneve apo dokumentave të klasifikuara si sekret shtetëror në fashikullin e procedimit penal, duke cënuar integritetin e informacionit, por edhe vetë vlefshmërinë e akteve të procedimit penal apo në tërësi në dosjes penale. Janë sjellë në vëmendje të prokurorëve rastet kur përfshirja e akteve sekrete në dosjen penale ka cënuar vlefshmërinë e dosjes penale dhe të gjykimit penal.

Një kujdes i shtuar është treguar sa i takon edhe faktit që aksesit me informacionet e klasifikuara si sekret shtetëror të jetë atribuar vetëm subjekteve që janë çertifikuar përshtatshëmrisht sipas ligjit. Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 04.03. 2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit” janë kryer edhe aplikimet për t’u pajisur me çertifikatë sigurie punonjësit të cilët kanë akses për t’u njohur me informacionet të kategorizuara si sekret shtetëror.

Udhëzimi nr. 4, datë 26.10.2018 “Për përgjimet, administruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën me nr. 2881 prot, datë 30.10.2018.

Ky udhëzim është analizuar dhe trajtuar në mbledhjen e prokurorëve duke u fokusuar në trajtimin analitik të disa çështjeve që janë trajtuar në këtë Udhëzim.

Objekt i diskutimit dhe vlerësimit ka qënë në mënyrë specifike edhe neni 1/5, i cili ka dhënë një definicion për konceptin e “vendit privat”. Në referencë të këtij udhëzimi janë analizuar vendimarrjet e gjykatave shqiptare, por edhe jurisprudenca e Strasburgut, me qëllim evitimin e interpretimeve të gabuara të nocionit të vendit “privat”, në funksion të një nga mjeteve më të rëndësishme të kërimit të provës, përgjimit.

Në vështrim të këtij Udhëzimi, objekt i diskutimit ka qënë edhe vendimarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në kuptim të kushteve të kërimit apo lejimit të përgjimit nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në raport me nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi.

Ndonëse dispozitat procedurale penale lidhur me Përgjimet i janë nënshtuar ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, të cilat në vlerësimin tonë nuk përbëjnë një ndryshim thelbësor në këtë mjet të kërimit të probës, ajo që konstatohet në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është standarti me i lartë i kërkuar nga ana e saj për të lejuar apo vleftësuar kërkesat që lidhen me përgjimet.

Një problem që është konstatuar dhe analizuar nga trupa e prokurorëve janë interpretimet e nenit 5/3 të Udhëzimit e që lidhet specifikisht me rastin kur njëri nga dy personat që do të përgjohen është i gatshëm të kryejë dhe të rregjistrojë veprimin përkatës, sipas marrëveshjes me oficerin e policisë gjyqësore. Praktika e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila është mbështetur edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017 ka qënë e tillë që është autorizuar vetëm me autorizim të Prokurorit, pa u miratuar kjo kërkesë në Gjykatë. Ndërkohë që vlerësojmë se për efekt të dinamikës së zhvillimit të këtij lloji përgjimi, por edhe teknikës legislative të përdorur në nenin 222/1/2/3/4, do të ishte më praktike dhe efikase që përgjimi i parashikuar nga neni 222/3 të lejohej vetëm me autorizim të prokurorit (ndonëse rregullimi ligjor procedural është i qartë për modalitetin se si duhet të zbatohet).

Prokurorëve ju është kërkuar të sjellin në vëmendje aplikimin e nenit 6 të këtij Udhëzimi, pasi të paktën për tre vitet e fundit kjo dispozitë ka gjetur një zbatim shumë të rrallë, për të mos thënë që nuk është zbatuar fare. Ndërkohë që pas këtij Udhëzimi, kemi patur raste të aplikimit të nenit 6 me qëllim gjetjen e personave të ikur dhe të dënuar me burgim.

Një rëndësi specifike i është kushtuar nenit 8 të Udhëzimit, duke kërkuar një bashkërendim sa më të saktë të veprimtarisë së prokurorëve lidhur me përgjimet (gjatë gjithë dinamikës së tyre) dhe personit të ngarkuar me administrimin e Rregjistrimit për Përgjimet”. Njëkohësisht në vëmendje të Prokurorëve dhe administratës përkatëse është treguar edhe lidhur me disiplinimin e procesit të rregjistrimit dhe përcjelljes së akteve që lidhen me përgjimit (kërkesat/materialet e përgjuara), elemente të përcaktuara në mënyrë shume të detajuar edhe në nenin 12 të këtij Udhëzimi.

Njëkohësisht prokurorëve ju është kërkuar që të tregojnë vëmendje edhe në rastet kur i drejtohen Gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes penale, të kërkojnë specifikisht edhe asgjësimin e proces-verbaleve dhe rregjistrimeve të përgjimit telefonik, duke respektuar edhe përjashtimet e parashikuara nga neni 12/4 dhe 12/7 i këtij udhëzimi.

Udhëzimi nr. 1, datë 20.02.2018 “Për krijimin e Seksioneve të posaçme”, në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Lezhë dhe Shkodër për hetimin e veprave penale sipas kompetencës të përcaktuar në Udhëzim, të nxjerë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes nr. 413 prot, e nr. 937 prot, datë 02.02.2018 ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm.

Në zbatim të këtij udhëzimi dhe Marrëveshjes mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka disponuar me nxjerjen e Udhëzimit nr. 57, datë 30.04.2018. Nëpërmjet këtij Udhëzimi (bashkëlidhur shkresës) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë krijuar dy seksione. Njëri prej seksioneve ka në kompetencën e tij hetimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, krimin ekonomik si dhe veprat penale që lidhen me substancat narkotike (veprat penale janë specifikuar në udhëzim) ndërkohë që seksioni tjetër, ka në kompetencë hetimin e të gjitha veprave të tjera penale.

Puna e Seksionit ka qënë efektive dhe vlerësoj se është shumë e rëndësishme qëndrueshmëria e përmbajtjes së këtij Seksioni, pasi ndihmon në specializimin e prokurorëve për protokolle të posaçme të hetimit, duke garantuar kështu

sukses dhe efektivitet më të madh në hetimin e veprave penale që janë objekt i punës të këtij Seksioni.

Udhëzimi nr. 6, datë 20.11.2018 “Për hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”.

Një nga çështjet që ka qënë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve në raport me këtë udhëzim ka qënë niveli i shtrirjes dhe zbatimit të nenit 3 të këtij udhëzimi. Meqënëse me udhëzimin nr. 6 është rritur shtrirja e veprave penale për të cilat kërkohet verifikimi pasuror, çështjet penale për të cilat mund të këtë një disponim qoftë për vendim pushimi të çështjes penale, apo dërgim të saj për gjykim, janë vetëm në nivelin e akteve procedurale dhe nuk janë të shoqëruara me hetim pasuror.

Në zbatim të këtij udhëzimi, e specifikisht nenit 12 të tij është dokumentuar një rregjistër i veçantë, për rastet e njoftimit të Prokurorisë për Krime të Rënda në lidhje me nisjen e hetimit pasuror si dhe rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprës penale.

Në zbatim të këtij udhëzimi është nxjerë edhe një udhëzim tjetër I përgjithshëm, me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij.

Sa I takon Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 5, datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”.

Njohja me këtë Udhëzim i ka shërbyer prokurorëve që në zbatim edhe të ndryshimeve që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35, të vitit 2017 të vlerësohet dhe trajtohet me një vëmendje specifike trajtimit procedural dhe etik i viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale. Në vështrim edhe të nenit 10 të këtij Udhëzimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë ekziston një Seksion, i cili në kompetencën e vet ka hetimin e çështjeve penale me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur. Në përbërjen e këtij Seksioni janë tre prokurorë magjistratë të cilët janë trajnuar në mënyrë të vazhdueshme lidhur me ligjin nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”.

Prokurororëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ju është tërhequr vëmendja lidhur me të drejtat e viktimës për tu përjashtuar nga pagimi i çdo shpenzimi për marjen e akteve dhe tarifës gjyqësore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në nenin 27/2 I këtij udhëzimi.

Nje element i rëndësishëm dhe të vlerësuar edhe me efekte praktike është dhënia e një përkufizimi të plotë në këtë udhëzim sa i takon definicionit të “viktimës”, trashëgimtarit të saj, si dhe përfaqësimit ligjor për viktimën e mitur, me paaftësi fizike apo intelektuale.

Referuar edhe qëndrimeve të ndryshme të mbajtur nga prokurorë të ndryshëm sa i takon çështjes se identifikimit të saktë të viktimave dhe specifikisht rasteve kur do të duhet ti referohemi trashëgimtarëve të viktimave neni 37 I këtij udhëzimi, ka qënë mjaft efikas dhe është sjellë në vëmendje të vazhdueshme të prokurorëve në mbledhjet tematike të organizuara nga kjo prokurori. Ndërkohë që neni 43 I këtij udhëzimi i ka dhënë një orientim që duhet patur në vëmendje nga gjithë trupa e prokurorëve lidhur me mënyrën se si duhet proceduar për të njoftuar viktimat që banojnë jashtë territorit apo viktimave me shtetasi të huaj.

Udhëzimi nr.10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimeve pasurore në Prokuroritë në Juridiksionit të Përgjithshëm”.

Ky udhëzim është vlerësuar si veçanërisht i rëndësishëm, pasi ka shërbyer për unifikimin e të gjitha masave administrative dhe procedural në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe për hetimet pasurore. Nga ana tjetër edhe zbatimi I nenit 4 të këtij udhëzimi që lidhet me krijimin e Seksioneve të Posaçme kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare ka shërbyer për ti dhënë një impuls të ri luftës ndaj krimit për këtë kategori veprash penale.

Sa i takon Udhëzimit nr. 12, date 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimine pavarësisë, ne prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” të Prokurorit të Përgjithshëm, vlerësoj se drejtuesi i prokurorisë duhet të këtë një

vëmëndje të shtuar për të marrë dhe administruar indicje lidhur me çështjet penale që shfaqin një rëndësi specifike referuar rëndësisë së faktit apo edhe llojit dhe natyrës së tyre. Në këto raste, drejtuesi i Prokurorisë duhet të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar informacion, por edhe për të dhënë udhëzime me shkrim, sipas ligjit. Po sipas gëmrës ç të nenit 43, të po të njëjtit ligj, drejtuesi ka për detyrë njëkohësisht edhe të verifikojë ecurinë dhe përfundimin e çështjeve si dhe të japë në dinamikë udhëzime përpara se të meret vendimi për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprahe. Në kuptim të nenit 42/dh të ligjit të sipërcituar drejtuesi i prokurorisë mbikqyr disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve.

Për sa më sipër, ndonëse prokurorët janë dhe duhet të operojnë në pavarësi të plotë dhe në mungesë totale të çdo lloj ndikimi të paligjshëm, pasi në thelb e gjithë puna e prokurorëve është lehtësisht e kontrollueshme nga gjyqtari i hetimeve paraprahe, në kuptim dhe analizë të dispozitave të sipërcituara krijohet një lloj dualiteti sa i takon mbikqyrjes së veprimtarisë së prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë. Drejtuesi i prokurorisë, i trupës tashmë të decentralizuar ka të drejtën që të kërkojë informacion për çështje konkrete penale, për të nxjerë udhëzime me shkrim me natyrë jo detyruese, për të mbikqyrur ecurinë dhe mënyrën e përfundimit të çështjes nga ana e prokurorit, por edhe të drejtën për të mbikqyrur disiplinën në punë të prokurorit.

Në këto kushte, roli i drejtuesit të prokurorisë, duhet të jetë një funksion i ushtruar në respektim të pavarësisë së plotë të prokurorit, por edhe në një mbikqyrje të moderuar të drejtuesit, i cili edhe për shkak të ndryshimeve procedurale merr informacione të plota mbi performancën e prokurorit edhe për shkak të njoftimeve që merr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me qëllim që në thelb të të gjithë procesit të garantohet zbatimi i ligjit material, procedural penal, udhëzimeve të prokurorit të përgjithshëm, por edhe respektimi i protokolleve më të mira dhe shteruese në hetimin e kategorive të veprave të ndryshme penale.

Në mbledhjet e përgjithshme të prokurorëve të zhvilluara në prokurori ka patur diskutime mbi problematikat që dalin lidhur me zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Është synuar që të inkurajohen që të përdorin më


gjerësisht urdhrat penale dhe marrëveshjet e fajësisë, me qëllim përfundimin e çështjeve në një kohë të shkurtër. Është kërkuar informacion lidhur me procedime penale të mbartura, apo të ngelura në hetim për një kohë relativisht të gjatë në përputhje me ligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 43 gërma b), c) dhe ç) , nenin 52/2, si dhe duke mbajtur në konsideratë detyrimin kushtetues dhe ligjor të ushtrimit të ndjekjes penale dhe të kontrollit të hetimeve paraprake, pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, me synim verifikimin e ecurisë dhe përfundimit të çështjeve të mbartura, drejtimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Policisë Gjyqësore, rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimit të çështjeve penale.

Gjithashtu janë organizuar mbledhje të vazhdueshme ku janë marrë në analizë procedime penale komplekse me synim dhënien rrugë për zgjidhjen e tyre në një afat sa më të shpejtë, janë zhvilluar disa takime me grupin hetimor të prokurorëve dhe opgj-ve që hetojnë çështjet e tërmetit; - Janë organizuar disa takime me oficerë të policisë gjyqësore pranë Komisarariatit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, me qëllim bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre edhe për sa i përket veprave penale sipas prioriteteve të rekomanduara; Janë nxjerrë gjithsej 20 udhëzime karakter jodetyrues dhe 4 akte konstatimi për procedime të ndryshme për vitin 2020; Në zbatim të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit i është përgjigjur me korrektësi kërkesave të ardhura në institucionin tonë, konkretisht duke trajtuar në total 14 kërkesa. Kthimi i përgjigjeve në të gjitha rastet është bërë në përmbushje të plotë të afateve kohore të përcaktuara në ligj dhe në asnjë rast e drejta për informim nuk është kufizuar. Mbrojtja e të drejtave të të miturve në procesin penal ka qenë në fokusin e punës së organit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës gjatë vitit 2020. – Megjithë këtë gjatë punës nga Seksioni i të miturve janë hasur edhe problematika që kanë të bëjnë sidomos me caktimin e masave të sigurimit për të miturit të cilët janë përsëritës në kryerjen e veprave penale, apo kanë qenë të dënuar më parë dhe në këto raste policia gjyqësore ka kryer arrestimin në flagrancë të tyre. - Për këtë problematikë bëhet shkak mungesa e institucioneve përkatëse për trajtimin e këtyre të miturve, të cilët vijnë nga familje me probleme të rënda sociale dhe ekonomike

dhe në disa raste janë braktisur nga prindërit e tyre. Si rrjedhojë ata janë të riskuar për t'u bërë kontigjent kriminal, kryesisht në kryerjen e veprës penale të Vjedhjes. - Përsa i përket hetimit të çështjeve penale me të mitur është e domosdoshme krijimi i kushteve dhe ambjenteve të përshtatshme për pyetjen e të miturve dhe sidomos të të miturve viktimat të veprave penale dhe të abuzuar seksualisht. Kjo është domosdoshmëri dhe kërkesë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2.2 Të dhëna dhe shjegime krahasuese për performancën.


Treguesit sasiore të kallzimeve penale: Gjatë vitit 2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë regjistruar gjithsej 2.516 kallzime dhe referime për vepra të ndryshme penale dhe duke shtuar dhe 10 kallzime të rregjistruara kyesisht, numri shkon në 2526 kallzime. Nga këto 37 janë të ardhura me transferim. Janë rregjistruar gjithsej 1796 procedime penale të reja dhe së bashku me 2031 procedime penale të mbartura në hetim nga viti 2023 përbëjnë një shumë totale prej 3.827 procedime penale për t'u trajtuar gjatë këtij viti. Nga këto 647 procedime penale janë hetuar për kundërvajtje penale dhe pjesa tjetër, pra 3.180 procedime janë hetuar për krime.



Nga ana e prokurorëve është vendosur mosfillimi për 902 kallëzime penale, ndërkohë që 177 kallzime penale janë në proces vlerësimi për vitin 2025. Veç këtyre, 1105 procedime penale janë trajtuar për parashkrim.

Totali i çështjeve të trajtuara		Procedime të reja	Mbartuara viti parardhës	Kallzime të Mosfilluara	Trajtuar për parashkrim
Viti 2022	3856	1266	1041	610	939
Viti 2023	5541	1627	1737	942	1235
Viti 2024	5834	1796	2031	902	1105


Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë:



Bazuar në analizë krahasuese, numri i çështjeve të trajtuara në total, është rreth 5,3 % më i lartë se çështjet e trajtuara në vitin paraardhës. Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2024 numri i procedimeve penale të regjistruara të reja është pak më i lartë në raport me vitin 2023, ndërsa numri i çështjeve penale të trajtuara për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, është rreth 11% më i ulët.

Burimet e referimit të çështjeve penale: Përsa i përket burimeve të referimit të çështjeve penale të regjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2024, vendin kryesor, si çdo vit, e zenë referimet e ardhura nga Policia e Shtetit.

Si gjithmonë shumica e shtetasve i drejtohen Policisë për vepra të ndryshme penale të kryera ndaj tyre. Këtë vit ka pasur 100 kallzime të ardhura nga shtetas dhe vetëm 40 nga këto kallzime janë regjistruar procedime. 55% e këtyre kallzimeve është mosfilluar, pasi shtetasit i drejtohen Prokurorisë për çështje që kanë të bëjnë më pronësinë, çështje që kërkojnë një zgjidhje bazuar në të drejtën civile dhe jo penale. Pjesa tjetër e kallzimeve nga shtetasit janë regjistruar procedime penale ose janë kallzime në proces verifikimi. Nga ILDKPI edhe këtë vit, po ashtu si dhe vitin e kaluar, nuk është depozituar ndonjë kallzim penal. Gjithashtu, vihet re se kallzimet penale të referuara nga institucionet shtetërore dërgohen në seksionet përkatëse të Policisë së Shtetit, të cilat i referojnë në Prokurori. Kjo i jep shpjegim deri diku numrit të ulët të kallzimeve të ardhura nga institucionet shtetërore, gjithsej 12 kallzime. Gjatë këtij viti ka 10 çështje të regjistruar kryesisht.




Ndërsa përsa ju përket veprave penale të referuara, numrin më të madh të kallzimeve penale e përfshijnë veprat penale kundër pasurisë dhe fushën financiare, ku pa dyshim vendin e parë e zë vepra penale e vjedhjes, vepër që lidhet kryesisht me faktorë socialë-ekonomikë. Në masë të konsiderueshme pasojnë krimet kundër autoritetit të shtetit dhe krimet kundër personit dhe jetës.


Analiza krahasuese e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale:

Gjatë vitit 2024, janë përfunduar një numër i konsiderueshëm i çështjeve penale. Kështu në total janë përfunduar rreth 3134 çështje, pra rreth 302 çështje më shumë se në vitin e kaluar, ose 11% më shumë. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë mënyrën e përfundimit të çështjeve krahasuar me dy vitet paraardhëse:

<i>Viti</i>	<i>Totali i çështjeve të përf.</i>	<i>Mosfillim</i>	<i>Pushim</i>	<i>Dërg. Gjyq. parashk.</i>	<i>Pezullim</i>	<i>Transferim</i>	<i>Dërg. Gjykim</i>	<i>Mbetur procedime në hetim</i>	<i>Mbetur kallzime</i>	<i>Mbetur për parashkrim</i>
2022	2269	610	240	747	220	19	433	1203	192	92
2023	2832	942	394	527	290	28	651	1768	223	709
2024	3134	902	773	403	430	39	587	1820	177	703

Grafiku i mëposhtëm tregon në përqindje, mënyrën e përfundimit të procedimeve penale në vitin 2023:





Grafikët tregojnë se ka një rritje me rreth 366 procedime penale të përfunduara ose rreth 25% më shumë, krahasuar me vitin 2023. Më e madhe në përqindje ka qënë rritja e çështjeve të dërguara për pushim, rreth 49% më shumë. Gjithashtu, duke ju referuar të dhënave statistikore rezulton se numri i mosfillimeve dhe mumri i pezullimeve kanë një ndryshim të vogël krahasuar me vitin 2023. Duke llogaritur që Prokuroria për rreth gjysmë viti ka punuar me rreth 50% të organikës, efekti i mungesës së prokurorëve ka sjellë një rritje të vogël të procedimeve të mbartura në hetim.

403 procedime që kanë plotësuar afatin e parashkrimit janë dërguar në Gjykatë për pushim. Ende mbeten në dorë mbi 700 çështje të kësaj kategorie. Problematike është kohëzgjatja e trajtimit të këtyre parashkrimeve në Gjykatë. Në shumë raste vendimi I pushimit vjen mbas disa vitesh.


Ky numër më i lartë i çështjeve të mbetura në hetim, kushtëzohet në një farë mase edhe nga ndryshimi i Kodit të Procedurës Penal, ndryshime të

cilat i kanë bërë edhe trupën e prokurorëve të kenë një lloj vlerësimi dhe trajtimi më të ndryshëm të diktuar shumë herë edhe nga qëndrimet e mbajtura nga ana e Gjykatës për çështje penale të konsoliduara në protokollin e punës së prokurorisë dhe të destinuara për t'u pushuar apo mosfilluar. Nga ana tjetër vlerësojmë se mungesa e numurit të prokurorëve ka qënë një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në rritjen e numurit të çështjeve të mbartura për vitin 2022 në raport me vitin paraardhës.

Analiza krahasuese e treguesit e të pandehurve:

Gjatë vitit 2024, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, janë trajtuar 1835 të pandehur dhe persona në hetim, nga të cilët 759 janë regjistruar gjatë vitit 2024. 1051 janë marë në cilësinë e të pandehurit. Janë dërguar për gjykim 822 të pandehur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga këta 11 janë dërguar për miratim urdhëri penal, 2 për gjykim me marrëveshje dhe 802 me kërkesë për dërgim në gjyq. Në krahasim me vitin 2023 konstatohet një numër përafërsisht i njëjtë të pandehurve dërguar për gjykim. Më poshtë jepet tabela krahasuese në tre vitet e fundit:

Viti	Totali i regjistruar	Të pandehur	Pers. në hetim	Pushuar apo Dërg. Për Push.	Transferuar	Push. Het. Pezulluar Çështja	Dërg Gjykim U.Penal Gj.Mar.	për + +
2022	1092	650	442	88 pers. + 44 Pand.= 132	18 pers. + +3pand. =21	3 p.het	601 pand	
2023	1580	931	649	55 pers. + 51 pand.= 106	2 pers. + 1 pand. =3	2 pers.	807 pand	
2024	1835	1051	784	135pers. + 124 pand = 259	12pers. + 9pand. =21	2 pers.	822 pand.	



Ngarkesa e punës së Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2024:

Gjatë vitit 2024, nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë që ishin pjesë e institucionit deri në fund të vitit, është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme pune si në fazën e hetimeve paraprake dhe në gjykim.

Nr.	Prokurori	Mosfillim	Gjithsej Proc.	Mbartur Het.	Regj. E Re	Gjithsej Përf.Proc	Pez.	Push DGj	K.Penale Push	Transf. + Bashkuar	Dërg.Gjyqit.Çësh.	Dërg.Gjyq.Pand.	Mbetur në Hetim	Parashkrim DGj.
1	Dh.Theodhor	22	251	173	78	160	66	38	9	3	35	97	91	44
2	A.Delilaj nga 01.08.2024	24	110	53	57	71	16	23	4	1	27	32	39	21
3	A.Kalanxhi	23	249	154	95	99	38	23	3	5	26	35	150	69
4	A.Shkrepi nga 01.08.24	33	131	52	79	43	8	15	1	3	16	20	88	4
5	A.Syri	115	535	278	257	250	22	68	37	6	94	110	285	3

6	A.Topçi nga 01.08.2024	32	121	57	64	49	6	16	4	0	23	27	72	11
7	A.Toska nga 04.12.2024	0	51	36	15	1	0	1	0	0	0	0	50	0
8	B.Zhuzhi nga 01.08.2024	29	100	35	65	10	1	3	0	1	5	6	90	7
9	I.Çunoti	58	153	47	106	129	30	22	7	4	63	77	24	12
10	E Babameto nga 01.08.24	21	114	53	61	43	2	16	3	2	20	21	71	4
11	E.Meçka nga 01.08.24	34	119	47	72	63	11	20	2	0	27	61	59	33
12	E. Prifti	85	385	126	259	149	31	37	23	1	52	55	236	5
13	K.Gjika nga 01.08.24	38	113	48	65	43	10	14	4	3	11	17	70	5
14	L.Shkurti	140	365	138	227	231	46	42	32	12	99	109	134	53
15	V.Postol	89	429	188	241	207	9	53	31	17	95	130	222	15

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se shumë prej prokurorëve kanë trajtuar gjatë fazës së hetimeve paraprake një numër të konsiderueshëm procedimesh dhe kallzimesh penale.

Tabela e mëposhtme jep në mënyre të detajuar statistikën e çështjeve që ka përfunduar gjykimi për çdo prokuror:

Nr.	Prokurori	Çështje të gjykuara	Të Pandehur të gjykuar
1	Dh.Theodhori	34	80
2	A.Delilaj nga 01.08.2024	7	9
3	A.Kalanxhi	20	31
4	A.Shkrepi nga 01.08.24	6	8
5	A.Syri	104	127
6	A.Topçi nga 01.08.2024	10	20
7	A.Toska nga 04.12.2024	2	2
8	B.Zhuzhi nga 01.08.2024	2	3
9	I.Çunoti	51	64
10	E Babameto nga 01.08.24	9	10
11	E.Meçka nga 01.08.24	7	25
12	E. Prifti	39	40

13	K.Gjika nga 01.08.24	8	11
14	L.Shkurti	83	96
15	V.Postol	73	87

Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprake:

Gjatë vitit 2024 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 258 çështje nga të cilat 126 çështje deri në 3 muaj, 50 deri në 6 muaj, 24 deri në 9 muaj, 19 deri në 1 vit dhe 39 mbi 1 vit. Rrethanat që kanë çuar në zgjatje të afatit të hetimeve lidhen kryesisht me vonesat në administrimin e akteve nga Drejtoria e Policisë Shkencore kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH Tiranë dhe informacioneve të tjera nga institucionet.

Përsa i përket kohëzgjatjes të afatit të hetimeve po japim tabelën e mëposhtme, bazuar në çështjet e përfunduara gjatë vitit 2024:

Afati i përfundimit	0-1 m	1-3 m	4-6 m	6-9 m	9-12 m	1-2 v	2-3 v	3-4 v	4-5 v	Mbi 5
Nr. çësh. 2023	1010	443	380	140	105	165	57	26	18	18
Nr. çësh. 2024	990	364	395	197	113	252	193	97	59	34

Për prokurorët nuk mund të jepet një afat individual i përfundimit hetimeve mbasi si rezultat i procesit të rivlerësimit dosjet kanë ndëruar prokuror disa herë.

Gjatë vitit 2024 nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, është përballuar një ngarkesë sipas të dhënave të pasqyruara më poshtë:

Emri i Oficerit	Kallzime	Mosfillime	Procedime	Të Pandehur	Arrest Burg	K P Push	D. Gjyq Pushim	Pezulluar	Transferuar	Dërg. Gjyqit	Përf Proc.+Mosf.	Përf. Pand.	Mbet.Het. Çësh	Hetim Pas.	Het.Pas.Përf.
Altin Malaveci	102	34	68	14	5	0	14	9	2	4	74	14	28	1	0
Eljona Mydini	149	50	99	31	7	9	9	7	1	36	127	33	22	0	0
Gerald Blaceri	114	6	108	16	3	7	22	42	0	14	100	18	14	2	0
Marinela Pilinci	159	30	129	33	10	4	27	15	1	38	131	35	28	0	0
Laert Civici	134	48	86	23	3	10	12	9	2	33	123	23	11	0	0
Pandush Nando	146	32	114	37	11	8	20	13	2	34	114	38	32	0	0
Piro Note	107	36	71	7	1	3	17	9	1	12	90	8	17	13	11
Besmir Tafa	129	23	106	42	13	16	12	24	2	35	119	43	10	0	0
Shiqiri Manjani	134	25	109	30	4	14	24	12	1	34	123	30	11	2	1
Stela Kokoneshi	122	10	112	45	1	16	19	39	0	15	100	46	22	6	3

Ashtu siç edhe rezulton nga të dhënat e mësipërme, oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, gjatë vitit 2024 kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme pune në fazën e hetimit paraprak.

2.4 Marrëdhëniet me publikun

Në shërbimet për publikun i është kushtuar rëndësi e e veçantë korrektësisë si dhe krijimit të imazhi të mirë të institucionit. Në ndarjen e vërtetimeve lidhur me ndjekjen penale, përparësi ka pasur lehtësimi i procedurave dhe shërbimi i shpejtë për publikun. Prokurori përgjegjës dhe koordinatori janë kujdesur që përgjigjet e kërkesave me shkrim, të ardhura nga shtetas apo institucione, të marrin përgjigje gjithmonë brenda afatit ligjor. Gjithashtu, është krijuar, me urdhër të brendshëm, një procedurë për shërbimin e fotokopjimit, pagesës dhe dorëzimit të dosjeve penale të kërkuara nga shtetasit, që ka rezultuar efikase. Ndihma që ju është dhëna viktimave të veprës penale, apo të miturve është trajtuar në paragrafët e mësipërm.

Në kushtet përgjate funksionimit të tij, si organ kushtetues Prokuroria ka qënë një strukturë e centralizuar dhe shume hermetike për publikun, mendoj

se për gjithë trupën e prokuroreve ka qënë disi sfiduese qasja me një Prokurori me te hapur me publikun. Megjithatë ajo që duhet kuptuar saktë dhe madje përcjelle me force është rigjetja e një lidhje me te ngushte mes Prokurorit dhe publikut, Kjo do te thote që Prokuroria duhet te jete me afer me komunitetin me qëllimin final per rikthimin e plote te besimit te besimit te publikut tek ne. Kjo do te thote jo vetem me shume sensibilizim te fuqise ndeshkuese te ligjit, por mbi te gjitha rritje të numrit të denoncimeve te publikut per vepra te ndryshme penale.

Nga ana ime si Drejtues janë marrë e masave organizative, procedurale, administrative për funksionimin e shërbimet për marrëdhëniet me publikun. Kështu eshte proceduar me caktimi i prokurorit dhe nëpunësin civil për marrëdhëniet me e prokurorisë me median, duke u bazuar tek specializmet e secilit prej tyre. Ndryshimi i prokurorit te medias, mund te jete bere vetem për shkak të një transferimi të mundshëm të tij, apo për shkak te procesit të rivlerësimit. Janë mare të gjitha masat për të siguruar mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin e shërbimeve si dhe për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Ka patur disa raste në këtë prokurori ku janë rregjistruar procedime penale kryesisht per evidentimin e rasteve të shkeljes së sekretit hetimor. Përgjatë vendosjes se një raporti efikas me Median, vleresoj se si Drejtuese e Prokurorisë duhet të jem me aktive ne përcjelljen e informacionit edhe për çështje penale te finalizuara me sukses, të cilat kanë ndjeshmëri për publikun, pavarësisht se sa i takon prespektivës se hetimit mund te jene çështje jo komplekse, por i përkasin rutines se veprimtarise së këtij Institucioni.


Qëndrimi aktiv në organizimin i konferencave ka qënë një tjetër element që eshte vleresuar si shume i rëndësishëm nga kjo Prokurori. Une vete, si Drejtuese e ketij Institucioni kam mare pjese ne disa konferenca për shtyp për çështje sensitive që kanë dëshmuar një nivel te larte te performancës së Prokurorisë Korçë.

Sa i takon marrjes se masave administrative-rregullative për të garantuar qasjen e publikut në prokurori, duke përcaktuar, dhe bërë publike oraret për pritjen e publikut, dokumentacionin e takimeve ose të shkresave për t'iu përgjigjur institucioneve të ndryshme, kjo çështje eshte zgjidhur duke i


orientuar subjektet e interesuara për të paraqitur kërkesa me shkrim për takim dhe për të trajtuar me orare specifike çdo kërkesë sipas nevojave të secilit prej tyre. Kjo gjë e ka lehtësuar edhe menaxhimin cilësor të kohës për secilin prej kërkuarësve, pasi Drejtuesi përgatitet paraprakisht për publikun dhe nevojat e tyre.

2.5 Analiza e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale:


Numri i procedimeve penale të përfunduara (pa përfshirë parashkrimet) është 1830. Grafiku i mëposhtëm tregon në përqindje, mënyrën e përfundimit të procedimeve penale në vitin 2024:



Grafiku tjetër tregon raportin midis kundërvajtjeve penale të pushuara dhe çështjeve të dërguara në gjykatë për pushim.




Prokurorët kanë vendosur dërgimin në seancë paraprake të 1374 procedimeve penale, ose 56% të procedimeve të përfunduara. Në grafikun e mëposhtëm jepet ndarja në përqindje e këtyre çështjeve.



Treguesit e mënyrës së përfundimit të gjykimit në seancë paraprake:

Gjatë vitit 2024, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë janë përfunduar gjykimet në seancë paraprake të 966 çështjeve penale.

Gjykimi për pushim: Ka përfunduar gjykimi në 353 çështje, nga të cilat në 312 raste është vendosur pushimi dhe në 41 raste janë kthyer aktet. Nga çështjet e kthyer vetëm 2 janë dërguar me kërkesë për gjykim, 10 janë ridërguar për pushim dhe të tjerat janë ende në hetim. Raporti i vendimeve të gjykatës në rastet e pushimeve jepet në grafikun më poshtë:



Urdhëri penal: Nga 23 çështje të gjykuara për miratim urdhëri penal, Gjykata ka miratuar urdhërin në 17 çështje me 18 të pandehur dhe ka kthyer aktet në 6 çështje me 6 të pandehur. Nga këto çështje 2 janë pushuar për kundërvajtje penale dhe 4 janë në hetim.


Gjykimi me marrëveshje: Nga 3 çështje të gjykuara për miratim të marrëveshjes të fajsisë, Gjykata në të 3 rastet ka miratuar marrëveshjen.

Gjykimi i drejtpërdrejtë: Me gjykim të drejt përdrejtë ka përfunduar gjykimi në 3 çështje me 3 të pandehur.

Treguesit e përfundimit të gjykimit: Gjithsej ka përfunduar gjykimi në 591 çështje si më poshtë:

Totali i çështjeve të gjykuara	Gjykim për miratim urdhëri penal	Gjykim me marrëveshje	Gjykim i drejtpërdrejtë	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshëm
591	24	3	3	520	41

Treguesit e mësipërm paraqiten në grafikë që vijon:



Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2024, është kërkuar dënimi i 800 të pandehurve. Kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës jepen në tabelën e mëposhtme:

Llojet e dënimeve	Kërkesa e prokurorisë	Vendimi i gjykatës
Dënim me gjobë	60	53
Paraburgim	0	1
Dënim me burgim (minimal)	7	5
Dënim me burgim (mesatar)	335	304

Dënim me burgim (maksimal)	0	0
Zëvendësim Burg-Gjobë	3	16
Qëndrimi në shtëpi	0	0
Pezullim ekzekutimi dënimi	308	312
Punë në interes publik	16	26
Shtrim i detyruar në spital	17	17
Burgim të përjetshëm	0	0
Kthim aktesh	30	30
Pushim Akuze	11	12
Pushim çështje	13	15
Pafajësi	0	14

Ekzekutimet e vendimeve penale: Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, për ekzekutimin e vendimeve penale gjatë vitit 2024 rezulton se janë ekzekutuar në total 544 vendime gjyqësore të formës së prerë, krahasuar me 535 vendime në vitin 2023. Nga këto janë 192 për ekzekutimin e vendimeve me burgim krahasuar me 132 të vitit të kaluar. 64 urdhëra kanë dale për ekzekutimin e dënimeve me gjobë krahasuar me 46 nga viti i kaluar dhe 292 për dënime alternative.

Në lidhje me dënimet alternative, për të cilat të dënuarit nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës, duke mos u paraqitur pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, apo gjatë kohës së provës kanë kryer një vepër tjetër penale, prokurori i ekzekutimit që ka qënë kryesisht prokurori që ka ndjekur çështjen penale ka qënë aktiv, duke kërkuar sipas rastit marjen e masave apo edhe revokimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale një prej problemeve është mungesa e adresës së saktë të të dënuarve.

Apelimet: Gjatë vitit 2024, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka paraqitur në gjykatë në total 5 ankime për masa sigurimi dhe 16 ankime për vendim themeli të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Ky numër është shumë i vogël krahasuar me 139 ankime për masë sigurimi dhe 205 ankime për çështje të shqyrtuara në themel, që kanë bërë të pandehurit.

Përgjithësisht, për çështjet e shqyrtuara në themel, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin. Për masat e sigurimit të apeluara, gjykata ka lënë në fuqi masën e sigurimit dhe në vetëm në një përqindje të vogël të rasteve ka dhënë masa sigurimi më të buta.

Ka patur një bashkërendim të mirë të punës me Prokurorinë e Apelit Korçë në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjykimit të çështjeve duke unifikuar qëndrimet dhe rakorduar praktikën për rastet e ngjashme.

Problematika që lidhen me veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë

Vendimet e pa ankimueshme dhe vonesat në dhënien e drejtesise

Ligjvënësi në nenet 332/c dhe 332/d të K.Pr.Penale i ka njohur Gj.S.P-së si pushtet kontrollin mbi hetimet paraprake si dhe akuzën e ushtruar nga Prokurorit por nuk ka parashikuar asnjë mjet efektiv mbi kontrollin nga ndonjë gjykatë më e lartë të këtyre llojeve vendimarrjeve si pasojë ato janë kthyer më vendimarrje që në disa raste janë të pa mbështetura në ligj me pasojë në dhënien e drejtesise.

Së pari : Neni 332/c i K.Pr.Penale mbi urdherimin për plotësimin e hetimeve nga Gj.S.P-të nuk është kryer një vlerësim i provave bazuar në standartin e provave të mjaftueshme, i cili është **standarti provues minimal**, i kërkuar për “kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, që është prova (burime) të mjaftueshme në mbështetje të akuzës (sikurse përcaktohet në gërmën “a” të paragrafit të parë të nenit 332/dh të KPP).

Mungesa e arsytimit të vendimarrjeve të gjykatave mbi nevojën për plotësimin e hetimeve nëse provat dhe veprimet hetimore janë realisht të domosdoshme bën efektivisht subjektiv analizimin e bazueshmërisë në ligj të këtyre vendimarrjeve kur nuk kemi operacion intelektual me standartin ligjor, por gjithsesi nga arsyetimet nënkuptohet se Gj.S.P-të kanë kryer operacionin intelektual të vlerësimit të akteve sipas standartit përtej cdo dyshimi të arsyeshëm duke tejkaluar rolin e njohur nga ligji dhe atribuimit vetes të kompetencave të gjyqtarit të themelit.

Ajo që bie në sy në vendimet për plotësimin e hetimeve është edhe roli tepër aktiv i Gj.S.P-së, i cili edhe pse nga i pandehuri paraqitet kërkesa për gjykim të shkurtuar dhe pranohet kryerja e vepres penale perseri urdherohen plotësimi i hetimeve madje duke pasqyruar edhe shuarjen e afateve të paragurgimit.

Gjykata e Kasacionit në Itali me Vendimin Nr.839/2017, datë 12.09.2017 ka elaboruar konceptin “*poca prova poca pena*” e shqipëruar “*pak prova pak dënim*”, mbi individualizimin e dënimit në rastet kur nga Prokuroria përmbushet standarti i provave të mjaftueshme ndërkohe që disa elementë të pa zbardhura

plotesisht nga aktet provuese që deduktoheshin nga teresia e provave barazekuilibroheshin me interesin publik të shpejtësisë në dhënien e drejtesise duke u aplikuar nga gjykata dënime jo të ashpra por duke ulur masën e dënimit.

Kjo filozofi ka shoqëruar punën e prokurorisë duke fokusuar hetimin në ato fakte dhe rrethana që mbeshtesin në thelb akuzën dhe fajësinë e të pandehurit duke nxituar në dhënien e drejtesise brenda afateve të arsyeshme, por me sa duket kjo mënyre pune nuk ka pelqimin e Gj.S.P-ve që duke mos patur filter kontrolli të veprimtarisë së tyre i kanë njohur vetës të drejta dhe pushtete në tejkalim të ligjit.

Së dyti : Në nenin 332/d pika 3 i K.Pr.Penale ligjvënësi i ka njohur si pushtet Gj.S.P-së disponimin për kthimin e akteve kur cilesimi juridik i faktit është i gabuar ose akuza nuk është formuluar qartë e sakte dhe nga prokurori refuzohet kryerja e korigjimeve.

Në interpretim sistematik edhe me nenin 329 pika 3 gërma c të K.Pr.Penale ku është parashikuar shprehimisht kthimi i akteve prokurorit duke e urdhëruar të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes në nenin 332/d pika 3 të K.Pr.Penale mungon parashikimi për urdherimin e Prokurorit për të formuluar akuzën sipas **“mendimit” të gjykates, e cila vetem kthen aktet përkundër me pushtetin e gjyqtarit të themelit i cili sipas nenit 375 të K.Pr.Penale mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm dhe ky vendim përfundimtar është objekt kontrolli nga gjykata e shkallëve me tjera.**

Maksima Latine “ *ubi lex voluitis dixit, ubi noluit tacuit*”, që përkthehet “ *ku ligji ka dashur ka folur, atje ku nuk ka dashur ka heshtur*”, na shërben për të konkluduar në interpretim literal, logjik dhe sistematik të nenit 332/d pika 3 të K.Penal se kthimi i akteve prokurorit nuk pas sjell nihilizimin e ushtrimit të ndjekjes penale nga Prokurori që vlereson se cilesimi juridik është ai i caktuar në aktin e akuzës dhe kërkesës për gjykim njëkohësisht nga debati i seances paraprake nuk ka rezultuar asnjë fakt i ndryshëm, prandaj edhe vendimarrja e ndërmjeteme e GJSP si një vendim i pa ankimushëm është pa fuqi juridike detyruese, pasi vendimarrjet detyruese janë vetëm ato sipas nenit 332/dh të K.Pr.Penale të cilat janë të ankimueshme kur lejohen.

Parashikimi i nenit 332/d pika 3 të K.Pr.Penale është kopjuar nga zgjidhjet e ligjvënësit Italian, konkretisht nenin 423 të K.Pr.Penale Italiane, i cili i është referuar jurisprudencës së Seksioneve të Bashkuara **S.U. 20.12.2007 n. 5307/2008** të Gjykatës së Kasacionit që kishin theksuar se parimi i marrjes në pyetje të kryqëzuar dhe nevoja që akuza të ishte “*e qartë dhe e saktë*” kërkonte që gjyqtari i seancës paraprake të kërkonte, në rast të një përsëkrimi jo të plotë të faktit që përbën krim, një shtesë e plotësim të akt-akuzës dhe rast se prokurori publik nuk e kishte modifikuar akuzën duke e bërë faktin kontestues mjaftueshëm të qartë dhe preciz për t’i lejuar të akuzuarit të mbrohet GJSP –ja do të duhej t’ia kthente dokumentet prokurorit publik.

Ftesa e gjyqtarit ka të bëjë me hipotezën në të cilën “fakti, rrethanat rënduese dhe ato që mund të çojnë në zbatimin e një mase sigurie” nuk tregohen në terma që korrespondojnë me atë që duket nga aktet dmth rasti në të cilin “cilesimi ligjor” është i pasaktë.

Utopia e ligjvënësit Italia për të kualifikimin ligjor që në seancën paraprake duke harruar se përcaktimi i kualifikimit të saktë ligjor përbën një nga përpjekjet interpretuese më komplekse të së drejtës penale. të cilin çdo gjyqtar është me arsye është i lirë ta përcaktojë, se shpesh nuk është e lehtë të vendoset se cili është përkufizimi i saktë ligjor dhe se në raste të ndryshme çështja trajtohet dhe vendoset përfundimisht vetëm në Gjykatën e Lartë është theksuar nga doktrinae cila shprehet se proceduralisht pas kthimit të akteve :

*Dy opsione do të mbeten. **Ushtrimi i ndjekjes penale sërish për akuzën e njëjtë tashmë të kontestuar fillimisht me rrezikun që gjyqtari i ri i seancës paraprake do të ftojë edhe një herë prokurorin publik që të ndryshojë rrethanat rënduese ose përcaktimin ligjor.***

*Në rast se prokurori **publik kokëfortë nuk e bën këtë, për shembull duke e konsideruar të saktë kualifikimin ligjor që ai ka propozuar, ekziston rreziku i një ngërçi procedural për të cilin ligjvënësi nuk ka menduar ndonjë zgjidhje.***

Në rast të ndryshimit të akuzës pas “sugjerimeve” të gjyqtarit të seancës paraprake, do të ekzistonte gjithmonë rreziku që gjyqtari i ri (i seancës paraprake) të konsideronte kualifikimin e ndryshëm ligjor si të pa saktë, duke e ftuar sërish prokurorin publik që ta modifikojë akuzën edhe në këtë hipotezë, një “qark i shkurtër” procedural pa zgjidhje.

*... tentativa për “thjeshtëzim” e miratuar nga ligjvënësi në ndryshimet e bëra me nenet. 423 paragrafi 1 bis dhe 554 bis paragrafi 6 c.p.p. – nuk ka marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjeve që kanë të bëjnë me kualifikimin ligjor të faktit, duke krijuar një cenueshmëri ndaj **parimit të pakthyeshmërisë së veprimit penal, i cili mund të vërë në dyshim legjitimitetin kushtetues të ligjit në rastet kur ndërmjet cilësimit ligjor te propozuar nga Prokurori dhe që gjykohet e pasaktë nga gjyqtari del si një mospërputhje e pazgjidhshme pikëpamjesh ose kur ftesa e gjyqtarit për të modifikuar akuzën ka të bëjë me eliminimin e veprave penale ose rrethanave rënduese¹.***

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin njësuës nr. 00-2021- 1134 (62), datë 01.11.2021 ka theksuar : ... *Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, **nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale***”.

Gjykata e Lartë jo pa qëllim është shprehur si më sipër pasi ajo ne Vendimin Njesues Nr. 312, date 16.11.2023 ka theksuar ne prg. 31 se nëse prokuroria arrin në përfundimin se ndodhet para provave dhe fakteve të mjaftueshme, ushtron ndjekjen penale ndaj personit të dyshuar si autor i veprës penale.

¹ *Irretrattabilità dell'azione penale e modifica della definizione giuridica dell'imputazione: è cambiato qualcosa? L'analisi degli artt. 423 comma 1 bis e 554-bis comma 6 c.p.p. introdotti dalla riforma Cartabia e la verifica della loro compatibilità con i principi costituzionali*
Di Giorgio Nicola

Në raste të tilla, prokurori i çështjes, në bazë të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave konkrete procedurale dhe materiale penale, ka detyrë të përfaqësojë dhe të mbrojë akuzën, duke kërkuar nga gjykata, mbi **bazën e provave dhe të fakteve të mbledhura, sipas rastit, dënimin e autorit të veprës penale. Këtu qëndron edhe veçoria e prokurorisë, pasi asnjë organ tjetër nuk është i autorizuar të ushtrojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq përveç asaj. Pra, procedimi penal dhe ngritja e akuzës publike është tagër e prokurorisë.** I takon këtij organi, në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24/3 të KPP, të ushtrojë ndjekje penale dhe të ngrejë akuzë publike në emër të shtetit, nëse ndodhet para kryerjes së një vepre penale të parashikuar si të tillë nga KP.

Duke qënë se ligjvënësi nuk ka parashikime për situatat e mësipërme me mjete ankimi të shpejta, efektive por edhe korigjuese dëmi që mund t'i shkaktohet procesit, nevojave të sigurimit por edhe ushtrimit efektiv të ndjekjes penale duhet të jetë objekt i inspektimeve tematike nga ILD për vlerësimin real rast pas rasti nëse ka patur nevoja për plotësim hetimor dhe mos administrimi i provave shtesë a do të cënonte drejtësinë / akuzën e prokurorisë.

Raste të hetimeve efektive të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë gjatë vitit 2024:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është regjistruar procedimi penal nr.147/2023, i cili më pas është ndarë në procedimin 147/2023 dhe në procedimin 147/1/2023. Procedimi penal nr. 147/2023, me të pandehur shtetasit Besnik Dine dhe Thanas Sholla, duke qënë se veprimet hetimore kanë qënë të plota, është dërguar për gjykim. Ndërkohë, në lidhje me procedimin penal nr. 147/1/2023, kanë vijuar veprimet hetimore deri në vërtetimin e plotë të fakteve penale.

Ky procedim është regjistruar mbi bazën e materialeve të dërguara nga ana e DVP Korçë me shkresën nr. 229 prot datë 20.02.2023, ku është referuar se, nga të dhënat dhe informacionet e mbledhura nga burime konfidenciale nga ana e Seksionit për Krimin Ekonomik e Financiar dhe Seksionit kundër Narkotikëve, ndër të tjera ka rezultuar se shtetasi Besnik Dine, në bashkëpunim me shtetasin Thanas Sholla dhe shtetasin Artur Rakip, bashkëpunonin në kryerjen e veprimtarisë së paligjshme në fushën e falsifikimit. Nga informacionet e tjera të siguruar, dyshohej se procesin e falsifikimit të dokumentit e kryente shtetasi Artur Rakip, i datëlindjes 26.03.1966, person me precedentë të mëparshëm kriminalë në fushën e falsifikimit. Ky i fundit dyshohej se dispononte pajisjet për fabrikimin e dokumentave në mënyrë të jashtëligjshme, në një apartament të ndodhur në rr. “28 Nentori”, në afërsi të “Tregut të bicikletave”, në qytetin e Korçës si dhe në banesën e tij në rrugën “Ndre Mjeda” të qytetit të Korçës. Ky procedim është hetuar me metoda hetimi proaktive si, përgjime, vëzhgime, blerje

të simuluar dhe si rezultat i tyre është provuar kryerja e veprave penale në fushën e falsifikimit. Në përfundim të hetimeve, është ngritur akuzë për shtetasit Besnik Dine dhe Thanas Sholla dhe çështja në ngarkim të tyre është dërguar për gjykim. Në përfundim të gjykimit në shkallë të parë, këta shtetas janë deklaruar fajtorë.

